

EXLIBRIS FORUM

KUFIJTË
E LETËRSISË
NË BALLKAN

Bisedë me autorët Drago Jančar nga Sllovenia, Dragan Velikić nga Serbia, Kalin Terziyski nga Bullgaria, Mehmet Kraja dhe Jeton Neziraj nga Kosova, Nikola Madzirov dhe Nurie Emrullai nga Maqedonia e Veriut si dhe Stefan Çapaliku nga Shqipëria. Gjithashtu mendime nga përkthyesit Ben Andoni, Nikollë Berisha, Milena Selimi dhe Rusana Bejleri.

Përgatiti Andreas Dushi

NDAHEN ÇMIMET
KOMBËTARE TË
LETËRSISË 2021

(fq. 24)

ROMANI "PROVINCA" I
LIRIDON MULAJT MERR
ÇMIMIN "REXHAI SURROI"
PËR LETËRSI

(fq. 13)

SHËNIME MBI LIBRAT

Rreth poezise së Preç Zogajt
MË SHUMË MUZA SE GRA
TË DASHURUARA (fq. 12)
Nga Fatbardh Amursi (Rustemi)

"MARTA" E POJANAKUT,
POETIT KONÇIZ E LAKONIK!
Nga Dr. Ilir Shyta (fq. 14)

PËRMASA KULTURORE
NË PËRKTHIM DHE
"MËKATET"
E PËRKTHYESIT
Nga prof.dr. Avni Xhelili

Në këtë shkrim preken vetëm disa çështje të transmetimit të realieve me ngjyime kombëtare që dalin në pah nga përplasja e kulturave gjatë procesit përkthimor të romanit "Mjeshtri dhe Margarita" të Mihail Bulgakov. (fq. 10)



2022 është viti i 100-vjetorit të lindjes së Thoma Kacorrit

THOMA KACORRI,
I FUNDMI I RILINDASVE

Nga Abdurrahim Myftiu (fq. 8)

Duhet të ketë qenë një punë e mundimshme, plot sakrificë, por edhe burim kënaqësie kjo "shtëpi e dytë" për Thoma Kacorrin, sepse puna e studiuesit e tillë është, plot mundime, sakrificë jetësore e kënaqësi bashkë. Do të doja që edhe të tjerë të ndjekin një shembull të tillë, kushedi sa vlera bibliotekash kanë mbetur pa u shfrytëzuar. Është shembulli kur njeriu bën histori, ndërmjet tjerash, edhe me mësimdhënien dhe studimet në lëmin e gjuhës dhe letërsisë shqipe jashtë Shqipërisë. Në këtë histori, si gur themeli qëndron puna dhe veprimtaria e pedagogut dhe e nxënësve të tij të Sofies.

GUERNIKA:
KRYEVEPRA E
DHIMBJES

Dr. Bledar Kurti



BIBLIOTEKË

- Ismail Kadare (fq. 16)
Dimri i fundit i vrasësit
- J. L. Borges (fq. 18)
Funesi - njeriu i kujtesës
- Dom Ndre Mjeda (fq. 9)
Ti ulesh prej Parrizit

EDICIONI I XVI-TË I EKSPOZITËS KOMBËTARE
"SALLONI I VJESHTËS"E KUQJA, KOZMOGONIA E
KOHË-HAPËSIRËS

Nga Dr. Oltsen Gripshi

Ekspozita është e konceptuar në aspektin kuratorial si një libër i realizimit magjik, i cili shfletohet vepër pas vepre dhe që mbart brenda vetes copëza të ndryshme të shpirtit krijues të secilit artist pjesëmarrës. (fq. 15)

Shënime nga festivali ndërkombëtar "Fikret
Demirag", në Lefke, pjesa turke e ishullit

POEZIA SHQIPE
PREZANTOHET NË QIPRO


Nga Olimbi Velaj (fq. 20)

ExLibris Forum

KUFIJTË E LETËRSISË NË BALLKAN

Bisedë me autorët Drago Jančar nga Sllovenia, Dragan Velikić nga Serbia, Kalin Terziyski nga Bullgaria, Mehmet Kraja dhe Jeton Neziraj nga Kosova, Nikola Madzirov dhe Nurie Emrullai nga Maqedonia e Veriu si dhe Stefan Çapaliku nga Shqipëria.
Gjithashtu mendime nga përkthyesit Ben Andoni, Nikollë Berisha, Milena Selimi dhe Rusana Bejleri.

përgatiti Andreas Dushi



Si mendoni se mund të arrihet që kufijtë e shteteve në Ballkan të mos jenë edhe kufij të letërsisë së secilit vend?

Dragan Velikić: Kjo frikë nuk është e arsyeshme, diçka e tillë vështirë të ndodh. Letërsia e mirë nuk është asnjëherë burg i një vendi të vetëm.

Drago Jančar: Kjo është një çështje që shkrimtarët nga ish-Jugosllavia gjithashtu janë përballur që në fundin e luftës dhe shpërpërjen e vendit. Në Panairin e Librit në Frankfurt, 1999, autorët nga të gjitha bagazhet gjuhësore dhe nga shtetet e reja frimosën një deklaratë të parbashkët në favor të rrjedhës së lirë të letërsisë, librave dhe ideve: Letërsia, me mesazhin e vet njerëzor dhe estetik, në transhedencën e vet të kufijve kombëtar – por kjo rrjedhë duhet të thjeshtëzohet përmes bashkëpunimeve, përkthimeve dhe shkëmbimeve.

Kalin Terziyski: Nuk ia thek shumë për politikë, nuk kuptoj nga kufijtë. Edhe pse kam qenë 2 vite ushtar në kufi me Jugosllavinë. Por mendoj se përkthimi i mirë mbetet një nga ato fuqitë e mëdha që i heqin kufijtë. Dikush mund të thotë - a nuk do të ishte më e lehtë të kalohet në një gjuhë globale dhe pikë? Por unë nuk kujtohem për një poezi të vërtetë, të njohur, ose një letërsi, që të jetë shkruar në gjuhën latine "intelektuale", pas rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit. Aq më pak të ketë një letërsi të mirë në latinisht, krijuar nga ata, për të cilët ajo ishte gjuhë zyrtare dhe jo amtare. S'ka një letërsi të mirë shkruar në latinisht nga gjermanët, madje as nga italianët.

Vetëm Erasmus shkroi vazhdimisht në latinisht, por latinishtja ishte qartazi gjuha amtare për të. Do të ishte e njëjta gjë nëse të gjithë do të fillonim të shkruanim në anglisht.

Të paktën në 200 vitet e parë asgjë serioze nuk do të lindte, më duket - sidomos në atë pjesë të letërsisë, që kërkon njohje të thellë të shpirtit. Dhe të frymës kombëtare. Le të kujtojmë këtu hipotezën e Sapir-Whorf - çdo gjuhë lind mënyra të ndryshme mendimi dhe prej andej - frymë shpirtërore të ndryshme. Kështu - unë i mbetem mendimit për ruajtjen dhe pasurimin e vazhdueshëm të gjuhëve të ndryshme në letërsi. Në diplomaci mund të ketë një gjuhë universale, por në letërsi s'është e nevojshme. Këtu del roli i përkthyesit të mirë. Të interpretit të mirë. Ai merr një krijim dhe e rishkruan në gjuhën tjetër, duke e transportuar në gjuhën dhe frymën e kombit - marrës. Ai krijon një vepër të re - por kjo vepër e re, natyrisht mban frymën e origjinalit. Vetëm se - ashtu siç mund të pasqyrohej kjo frymë në botën gjuhësore të kombit tjetër.

Shkrimtari duhet të shkruajë në gjuhën e vet. Dhe të përpiket që kjo gjuhë të

Në numrin e fundit për vitin 2022, ExLibris prezanton rubrikën e re ExLibris Forum. Herë pas here, tematika të caktuara do të diskutohen mes disa njohësve të tyre dhe specialistëve të fushave ku të këtitilla tematika zënë vend. E para është *Kufijtë e letërsisë në Ballkan*.

Realiteti gjeopolitik i gadishullit tonë, duhet të jetë edhe realiteti letrar i tij? Pesë çështje të lidhura me këtë, si i mendojnë shkrimtarët nga Sllovenia, Bullgaria, Serbia, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria? Po përkthyesit e këtyre shkrimtarëve në shqip apo të letërsisë shqipe në bullgarisht?

ExLibris Forum i parë ndahet në dy panele pra, i pari me shkrimtarët e dyti me përkthyes. Mendimet janë nga më të ndryshmet, shpesh ai i njërit kundërshton të tjetrit... Por këtu qendron e veçanta!

Si e shohin raportin mes letërsisë dhe kufijve dy shkrimtarë të Kosovës, Mehmet Kraja – kryetar i Akademisë së Shkencave të Kosovës, shkrimtar me një karrierë të shtrirë ndër dekada dhe Jeton Neziraj – dramaturgu shqipshkrues më i suksesshëm ndërkombëtarisht; si e shohin dy shkrimtarë që banojnë në Maqedoninë e Veriut, Nikola Madzirov i kombësisë maqedonase dhe Nurie Emrullai, shqiptare e Maqedonisë; si e sheh një shkrimtar serb si Dragan Velikić, një bullgar me jetë të larmishme si Kalin Terziyski, një slloven i përmendur edhe si kandidat i mundshëm për "Nobel" si Drago Jančar dhe një shqiptar, akademik i asociuar, profesor për vite me radhë, shkrimtar e studiues, i përkthyer në pjesën më të mirë të gjuhëve ballkanike dhe të tjerave më kryesore evropiane si Stefan Çapaliku?

Falenderoj përzemërsisht secilin prej të pranishëmve që ftesën time e pranuan menjëherë, sidomos Milena Selimin e cila përktheu nga bullgarishtja përgjigjet e Kalin Terziyskit dhe Enxhin që më ndihmoi me përkthimin e përgjigjeve të të tjerëve nga anglishtja, sidomos të Nikola Madzirov.

Paneli I i ExLibris Forum "Kufijtë e letërsisë në Ballkan" Shkrimtarët ballkanikë

Drago Jančar është romancier, dramaturg dhe eseist slloven; shkrimtari slloven më i përkthyer. I vetmi shkrimtar që ka fituar katër herë çmimin prestigjioz *Kresnik* për romanin më të mirë të vitit, së fundmi me "Dhe dashuria gjithashtu" në 2018. Jančar ka marrë disa çmime letrare, si: Çmimin e artit më prestigjioz të Sllovenisë, *Prešeren* në 1993; Çmimin Europian për Prozën në Augsburg në 1994; Çmimin austriak *Jean Améry* në 1997; Çmimin *Kresnik* për romanin më të mirë të vitit në 1999, 2001 2011; Çmimin gjermano-austriak *Herder* për Letërsinë në 2003; Çmimin Europian në Letërsi (EUPL) në 2011; Çmimin francez *Prix de l'Inaperçu* në 2012 dhe Çmimin francez të Librit më të Mirë të Huaj në 2014. Në vitin 2020 ai mori Çmimin Shtetëror austriak për Letërsinë Europiane. Është Doktor Nderi në Universitetin e Mariborit.

Dragan Velikić u lind në Beograd në 1953. Ai është diplomuar për Letërsi të Përgjithshme në specializimin e Teorive Letrare në Fakultetin Filologjik të Beogradit. Editorialist në *NIN*, *Vreme*, *Danas*, *Reporter* dhe *Status*. Ai ishte Ambasador i Republikës së Serbisë në Austri (2005-2009). Jeton në Beograd si shkrimtar i pavarur. Romanet e botuara: *Via Pula* (Çmimi *Miloš Crnjanski*), *Astragan*, *Hamsin 51*, *Muri* i Veriut, *Sheshi Dante*, *Çështja Bremen*, *Dosja Domasevski*, *The Russian Window* (2007 - Çmimi "NIN" për Romanin më të Mirë, Çmimi "Meša Selimovic" për librin më të mirë atë vit, Çmimi i Europës Qendrore për Letërsi, *Bonavia*. *Librat* e tij janë përkthyer në pesëmbëdhjetë gjuhë europiane. Ai është fituesi i Çmimit të Qytetit Budapest për vitin 2013.

Kalin Terziyski u lind në mars 1970 në Sofje të Bullgarisë. U diplomua për Mjekësi dhe punoi si psikiatër në spitalin "Shën Ivan Rilski". Gjatë kësaj kohe ai shkroi një sërë tregimesh dhe tekstesh alternative për gazeta dhe revista. Në fillim të viteve 2000, braktisi karrierën mjekësore për t'iu kushtuar të shkruarit. Vepër e tij përfshin romane, përmbledhje me poezi, si dhe përmbledhje me tregime të shkurtra. Përmbledhja me tregime "A ka njeri që ju do?" (2009), është vlerësuar me Çmimin Europian në Letërsi (EUPL) në vitin 2011.

Mehmet Kraja u lind më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1974-76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi si gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Gjatë viteve 1992-99 jetoi dhe punoi në Tiranë. Pas luftës ishte redaktor i kulturës në të përditshmet "Zëri" dhe "Koha Ditore". Që nga viti 2002 është edhe ligjërues në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ku jep lëndën e skenarit të filmit dhe prej vitit 2020, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Është autor i pesëmbëdhjetë romaneve, disa vëllimeve me tregime si dhe disa dramave.

Jeton Neziraj ka shkruajtur rreth 15 pjesë teatrale të cilat janë vënë në skena të vendeve të ndryshme në Europë dhe SHBA. Shkrimet dhe dramaturgjia e tij është përkthyer në më shumë se 10 gjuhë, duke përfshirë këtu: anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, sllovakisht, maqedonisht, sllovenisht, kroatisht, rumanisht, spanjisht, turqisht, bullgarisht, serbisht si dhe në gjuhën boshnjake. Drama e tij "Liza po fle" fitoi çmimin e parë në një konkurs kombëtar për shfaqjet teatrale shqiptare, një konkurs i organizuar nga shtëpia botuese "Buzuku" si dhe pati premierën në Teatrin Kombëtar të Kosovës në 2007. Ai ka shkruar shumë skenarë tetral të cilët janë prodhuar dhe ekranizuar më pas në Kosovë. Ai ka shkruar skenarin e filmit me metrazh të gjatë "Donkey of the border", i cili pati premierën e tij në tetor 2010 dhe që prej atëhere është shfaqur në dhjetëra festivale ndërkombëtare. Ai ka punuar ngushtësisht me teatro dhe kompani si përshebull kudo në Evropë.

Nikola Madzirov është poet, eseist dhe përkthyes. Ka lindur në vitin 1973 në Strumicë, Maqedonia e Veriut. Poezitë e tij janë përkthyer në më shumë se dyzet gjuhë. Për librin "Guri i zhvendosur" ka fituar çmimin e poezisë "East European Hubert Burda" dhe çmimin më prestigjioz maqedonas *Vëllezërit Miladinov*. Çmimin *Studentski Zbor* dhe çmimin *Xu Zhimo Silver Leaf* për poezinë europiane në *King's College*, në Mbretërinë e Bashkuar.

Kompozitorët amerikanë Oliver Lake, Michael League dhe Beça Stevens kanë kompozuar këngë bazuar në poezitë e Madzirov. Fitues i bursave ndërkombëtare: Programi Ndërkombëtar i Shkrimit (IWP) në Universitetin e Iowa-s; DAAD në Berlin; Marguerite Yourcenar në Francë ose Civitella Ranieri në Itali. Nikola Madzirov është një nga koordinatorët e rrjetit ndërkombëtar të poezisë Lyrikline, me seli në Berlin.

Nurie Emrullai u lind në Kërçovë, më 28 tetor të vitin 1992, të Maqedonisë së Veriut. Ka mbaruar fakultetin e Filologjikut, dega Gjuhë dhe Letërsi shqipe në Universitetin "Fadil Sulejmani" - Tetovë dhe ka përfunduar Masterin për Letërsi po aty. E punësuar si mësimdhënëse në shkollë fillore dhe si asistente pranë Universitetit "Fadil Sulejmani" - Tetovë.

Tani është kandidat e Doktoratës në Fakultetin Filologjik "Blazhe Koneski" Shkup.

Në vitin 2018 ishte përfaqësuese e letërsisë në Forumin e Literaturës CEEC që u mbajt në Ningbo të Kinës. U përzgjedh në Karvanin Poetik që u mbajt në shumë qytete të Maqedonisë së Veriut në dhjetor të 2018. Ishte pjesë e edicionit FemArt2019, në Kosovë. Qe pjesë e Festivalit të Netëve Strugane të Poezisë, 2021, pjesë e Festivalit të letërsisë "Polip", 2021. Poezia e saj është vlerësuar kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht me çmime të ndryshme.

Stefan Çapaliku u lind në Shkodër në vitin 1965. Është shkrimtar, profesor dhe publicist. Ai u diplomua për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës në 1988 dhe pasoi me studime të mëtejshme në Itali, Republikën Çeke dhe Angli. Dramat e tij janë interpretuar në disa festivale ndërkombëtare të teatrit, ku atij i janë dhënë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Pjesë nga veprat e të tij në poezi, prozë, drama dhe ese janë përkthyer në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, rumanisht, polonisht, bullgarisht, serbisht, maqedonisht dhe turqisht. Stefan Çapaliku u shpall nga Ministria e Kulturës dhe organizata të tjera si dramaturgu më i mirë për vitet: 1995, 2003, 2007, 2012, 2016. Në vitin 2021 Stefan Çapaliku u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

pasurohet sa më shumë. Ndërsa përkthyesi të bëjë të mundur që vepra e përkthyer të pasurojë edhe gjuhën e vendit ku përkthehet - sepse idetë, të mëkuara nga shpirti i një populli (falë gjuhës dhe kulturës së saj të veçantë), nëse përkthehen saktë- do të jenë një risi e mrekullueshme për kulturën dhe gjuhën ku hyjnë pas përkthimit.

Mehmet Kraja: Jo, nuk është e mundur, këto janë iluzione, por si koncepte vijnë nga shoqëria civile dhe OJQ, që merren me tolerancën dhe gjëra të këtilla. Letërsia ka kufij gjuhësorë, nuk ka kufij shtetëror dhe unë mendoj se ata kufij janë të pazhdukshëm, sepse letërsia është gjuhë dhe vetëm ai që e ka të zhvilluar sensin e gjuhës mund ta bëjë letërsinë.

Jeton Neziraj: Gjë mjaft e vështirë, gati e pamundur! E pamundur sepse, megjithatë, qarkullimi i letërsisë përtej 'kufijve gjuhësor' kushtëzohet para së gjithash nga përkthimi, i cili pastaj është i kushtëzuar nga interesimi i botuesve dhe lexuesve dhe nga burimet financiare. Dhe, në rrethanat e letërsisë në Ballkan, asnjë prej këtyre kushteve nuk ekzistojnë. Interesim ka fare pak, si nga ana e botuesve ashtu edhe nga ana e lexuesve, por edhe burime financimi ka pak. Njëlloj përpjekje në këtë drejtim e bënë TRADUKI, por kjo ka qenë dhe është e pamjaftueshme. Por përtej këtyre 'teknikaliteteve', unë mendoj që megjithatë, problemi kryesor është tek kureshtja. Ka fare pak kureshtje për letërsinë që shkruhet 'përtej kopshteve tanë'.

Nikola Madzirov: Kufijtë e letërsisë janë ndryshe; ato u ngjajnë izohipseve në atlasë të cilat lidhin vendndodhjet me lartësi të njëjtë. Këto kufij janë shumë më të hollë se kufijtë shtetërorë, gati të padukshëm, por janë thelbësorë për lidhjet që shkojnë përtej logjikës territoriale dhe historike. Policia kufitare kontrollon vazhdimisht me dyshim valixhen time plot me libra dhe gurë nga vendet ku kam qenë ndërkohë që hija ime, e cila nuk është në pasaportën biometrike, është tashmë në anën tjetër të kufirit. Ashtu siç fjalët tona udhëtojnë shumë më larg se prania jonë fizike. Kufijtë truporë, historikë, dhe letrarë nuk janë të barasvlershëm. Kufijtë historikë më të papenetrueshëm gjenden në Ballkan. Yehuda Amichai e fillon poemën "Diku" me vargjet: "Diku / shiu nuk është më, por kurrë / s'kam qëndruar në kufi, / ku njëra këmbë është ende / e thatë e tjetra laget në shi". A mund të imagjinohet një imazh më i thjeshtë që shfaq kompleksin absurd të kufijve?

Nurie Emrullai: Letërsia nuk është gjë e vogël, as nuk është gjë e cila mund të anashkalohet, apo të themi se është e panevojshme. Letërsia është ajo që përmbledh në vete ndarjen e popujve, ndarjen e kufijve, rindërtimin e tyre, shkatërrimin e shumë kulturave e qytetërimeve, e tashmë njësimin e një rruge të vetme që po kaplon të gjithë popujt.

E përgjithësoj në mënyrë të këtillë, qëllimisht për të treguar peshën të cilën e mban letërsia, e përpara së cilës humbet çdo vijë harte.

Kufiri i parë që u vendos mes njerëzve dhe gjuhës ishte ndërtimi i Kullës së Babelit. Shpjegim që e jep Bibla, ku njerëz vendosën të ndërtonin një kullë maja e së cilës do të rrokte qiellin. Atëherë Zoti, (një histori që vazhdon të përsëritet), secilit i dha një gjuhë ndryshe nga tjetri, qëllimisht për të mos u kuptuar me njëri-tjetrin e kështu të humbin forcën që e kishin bashkë. Pra, siç është dëshmuar, forca e njeriut ekziston në gjuhë. Forca e popullit jeton në letërsi.

Por, nisur nga pyetja juaj, këtu kam parasysh faktorin kohë, faktorin politik, identitetin dhe në anën tjetër është liria për të krijuar, pa të cilën arti nuk mund të ekzistojë apo të jetë art i mirëfilltë; liria e të



Drago Jančar

shprehurit që nuk njeh as kornizë kohore dhe as territoriale.

Por, a nuk jemi dëshmitarë të historisë që tregon se politika nuk qe dashamirë ndaj letërsisë së vendit të saj? Madje e ka dëmtuar, duke ia cënuar lirinë. Ndoshta, po themi ka rast kur ia ka dhënë vendin që e meriton, por dhe atëherë e ka përdorur si karrem për të depërtuar zakonisht më afër masës. Dua të them që letërsia nuk jeton sipas kufijve, madje as nuk i duron ato në vetvete. Përkatesia që shkrimtari e ka të nevojshme është diçka tjetër, madje e kuptueshme, por kurrë nuk është e njëjta nevojë për krijimtarinë e tij.

Stefan Çapaliku: Përsionalisht mendoj se larushia, diversiteti është pasuria më e madhe që paraqesin Ballkanet në pikpamje kulturore. Antropologjia ballkanase është krejtësisht e ngjashme me natyrën e gadishullit. Tre njësitë gjuhësore të ballkanit klasik: greqishtja, shqipja dhe sllavishtja krijojnë një treshe shumë interesante. Nga një pikpamje këto identitete linguistike janë të pakonvertueshme te njëra-tjetra dhe fatlumësisht na bëjnë ne të ndryshëm. Në këtë kontekst edhe përkthimi në vetvete duhet parë si *kitsch*.

Visar Zhiti i ka tha një politikani atë shprehje e cila për mendimin tim përshkruan më së miri raportin mes letërsisë dhe politikës: "Letërsia jonë është më e mirë se Shqipëria juaj." Po ta vendosni në kontekstin e atdheut ku ju jetoni, si e mendoni këtë thënie?

Dragan Velikić: Nuk është mungesë modestie të thuhet se kjo vlen për të gjithë rajonin. Nuk ka formate të tilla mes politikanëve tanë ashtu sikurse ka mes artistëve.

Drago Jančar: Do të guxoja të bija dakord me këtë vështrim interesant. Sllovenia është një vend i hapur dhe demokratik, por politikanët e saj janë në një konflikt të përhershëm interes, lufte për karrige, mirëqenieje dhe medie. Letërsia përmes historive të veta e kupton më mirë të shkuarën dhe e prezanton në shtetin e saj, mbi të gjitha sepse kupton jetën dhe mallin e qenies njerëzore.

Kalin Terzijski: Letërsia gjithmonë është më e mirë nga politika e një vendi. Thjesht sepse shkrimtarët janë zakonisht më të zgjuar se politikanët. Përse atëherë- do të pyeste dikush- shkrimtarët nuk qëndrojnë pranë politikanëve? Që edhe politika të bëhet e mirë dhe e mençur? E para- sepse është e neveritshme të jesh politik. I jam afruar politikës- shëmti dhe mëzri më të madhe s'ka. Është e dobishme - por edhe larja e tualetit është gjithashtu e dobishme, vetëm se jo të gjithëve u pëlqen t'i lajnë. E dyta- shkrimtarët që rastësisht bëhen politikanë- sikur budallallexen. Të paktën

përkohësisht. Ata janë njerëz delikatë (flas këtu për shkrimtarët e vërtetë, ata të mirët) dhe fillojnë e marrin parasysh mendimet e të tjerëve. Dhe kështu njerëz të thjeshtë, mashtrues dhe budallenj - nga të cilët ka shumë politikanë - fillojnë t'u imponohen atyre. Dhe shkrimtarët bien në një... ta quajmë "marrëzi e kushtëzuar nga shoqëria". Kur ikin nga politika- në përgjithësi ndreqen. Mario Vargas Llosa- nuk e di- por mendoj se si shkrimtar ia del më mirë. Si politikan më dukej i çuditshëm. Shkrimtarët më mirë të qëndrojnë jashtë politikës dhe të vëzhgojnë e të shprehin mendime të zgjuara që politikanët (të bëhen të dashur e të arsyeshëm) t'i lexojnë e të marrin mësim.

Mehmet Kraja: Jo, nuk mendoj ashtu, përkundër faktit se kam respekt për Visar Zhitin. Ndarjet e tilla janë artificiale, sepse edhe "letërsia jonë e mirë" dhe shkrimtarët e saj mbajnë një pjesë të përgjegjësisë për atë "Shqipërinë tjetër", e politikës ose e kujtdo qoftë. Shkrimtarët nuk janë qenie jashtëtokësore, as letërsia e tyre nuk është fenomen i jashtëkohshëm. Nëse "Shqipëria juaj" ose "Kosova ime" nuk është ajo që dëshirojmë, atëherë në esencë ka dështuar misioni i letërsisë për ta bërë botën më të mirë. Edhe koncepti politikë është i papërthekueshëm...

Jeton Neziraj: Në çdo rrethanë, kjo shprehje 'poetike' e Visar Zhitit qëndron. Letërsia nuk është dhe nuk ka qenë asnjëherë aq shumë e kontaminuar, siç kanë qenë shoqëria e politika, sidomos në vendet tona të rajonit. Letërsia është pararoja, ose aspirata e synuar e një shoqërie, ajo është 'ëndërra e pajetuar' e një shoqërie, nga ajo pritret të jetë më e mirë sesa shoqëria të cilën e projekton politika. Projekcioni i letërsisë për një vend është dhe duhet të jetë, sa kritik, poaq edhe utopik. Natyrisht, po flasim për letërsinë e lirë dhe jo për atë lloj letërsie që prodhohet e kontrolluar dhe sanksionur nga



Dragan Velikić

kallëpet ideologjike të inxhinierisë politike a religjioze.

Nikola Madzirov: Pohimi i bërë nga Visar Zhiti përmban vlerë universale. Deklarata nga Danilo Kish se "poezia është dyshim dhe ideologjia është mungesa e dyshimit" kap më së miri marrëdhënien mes poezisë dhe ideologjisë. Të vetmet ngjashmëri mes poezisë dhe politikës, sipas Brodskit, janë shkronjat 'p' dhe 'o'. Ideologjia, e cila është mungesa e kohës personale, qëndron në kundërshti me jetën. Është në fazat përfundimtare të vdekjes. Mundet vetëm t'u japë monumente udhëheqësve, nën hijen e bronzit të të cilëve takohen dashnorët që janë të pavetëdijshëm për horrorret e historisë. Pavarësisht pamjes së brishtë, poezia shpesh bën kërdrinë në shoqëritë me regjiment të lartë. Sepse krijojnë kuptimet e para dhe absolute, udhëheqësit e përjetshëm kanë frikë nga metafora, kuptimi i dytë i fjalës. Në parada festa, varreza ushtarake dhe jubile shtetërorë, gjithçka është simetrikisht e vdekur, gjë që mjafton për të unifikuar frikën dhe për të veçuar fajin e vetëaktuar si element shoqëror i njohjes. Kanë barazuar realitetin dhe simetria është gjuha e tyre e fuqisë. Ideologët dhe profetët falsë kanë pak të përbashkëta pasi krijojnë të ardhme pa kujtime. Njerëzit gjithmonë do të duan të lënë struktura dhe citate mbresëlënëse në gurët e tyre të varrit, por nuk do të harrojnë etiketat në kavanozat e gjërave që nuk gjenden më apo vendeve ku ngecur kaseta e muzikës. Letërsia është thelbësore pasi na lejon të përdorim historitë tona si dëshmi kundër historisë zyrtare në një sallë gjyqi të pafundme.

Nurie Emrullai: "Kombin e bëjnë poetët, kjo dihet. Ata, qeveritarët,- ai bëri me dorë në një drejtim si të tregonte këndin ku gjendeshin,- kur bëjnë ndonjë punë, ndonëse bëjnë sikur na kanë harruar, tek ne e kanë mendjen. Ç'do të thotë Lasgushi për këtë? Ç'do të thonë poetët?" (Ikja e Shtërgut, Ismail Kadare)

Letërsia është grumbullimi i përvojave njerëzore, përvoja që në ne kanë skalitur eshtra. Dhe kjo nuk ka qenë e mundur të kalojë në heshtje. Koha gjithnjë për ne ka çelur plagë, që i kemi përetuar jo lehtë, si ne nga kjo anë e kufirit, apo edhe popujt e tjerë që kanë pasur histori përsëritëse sikurse ne.

Por, letërsia nuk e duron një vijë të tillë ndarëse, ndaj ajo është më e vërtetë se çdo gjë tjetër që na rrethon apo na serviret si e tillë.

Sa e lehtë dhe e kapshme është për syrin që të befasohet me materialen, e do atë që e sheh dhe e pranon shumë më shpejt se sa mund që të pranohet apo të bëhet pjesë e kulturës një vepër letrare.

Unë jam rritur me atdhe të munguar. Se më thoshin të gjithë se gjithnjë duhet të jemi atje, dhe atje unë nuk e dija ku ishte. Nuk e dija se po të jem këtu, jam dhe atje, jam dhe kudo. Ndaj letërsia është shpëtimi ynë sepse nuk na la kurrë jashtë vetes, na lejoi të jetonim atje, na pranoi si pjesë të saj, se ne të saj edhe jemi.

Stefan Çapaliku: Ndaj edhe unë të njëjtin mendim me Visarin. Edhe unë e kuptoj krejt qartë se nuk është e thënë që vetëm letërsia të frymëzohet nga historia, por mundet që edhe historia të ndriçohet nga letërsia. Letërsia e ka shpallur prej kohësh veten si një medium pengues që e kaluar të mos i prijë së ardhmes. Modele të tilla letërsie do na duhet që t'i servirim përherë e më shpesh njeri-tjetrit.

Ballkani gjendet mes dy forcave polare që tërheqin nga kahe të kundërta: nga poshtë kemi historinë tonë të përbashkët ndën perandorinë turke dhe nga lart kemi perspektivën tonë të përbashkët evropiane. Të gjitha forcat e tjera vepruese duket se na ndajnë dhe na diversifikojnë.

Në Ballkan, a mund dhe a duhet të shërbejë letërsia edhe si një mjet paqeje?

Dragan Velikić: Letërsia nuk duhet t'i shërbejë askujt, sepse letërsia autentike punon në veteve për të kontribuar lidhur me mirëkuptimin mes njerëzve, sigurisht, mes atyre që lexojnë.

Drago Jančar: Fatkeqësisht, ishte pikërisht Ballkani vendi ku disa shkrimtarë u përfshinë në lëvizje dhe rryma ideologjike e nacionaliste që çuan në konflikte të tmerrshme. Fatmirësisht, shumica e letërsisë nuk është e tillë. Letërsia gjeneron kureshti dhe interes të komshiu, te historia e tij, kultura e tij, jeta e tij. Në veteve kjo është gjithashtu një thirrje për tolerancë dhe mirëkuptim. Dhe për paqe, sigurisht.

Kalin Terziyski: Nëse nuk shërben si instrument paqeje - atëherë nuk do të jetë letërsi. Letërsinë që lavdëron luftën, apo qoftë edhe e pranon luftën si diçka të lejuar, e hedh në WC. Dhe shkarkoj ujën.

Mehmet Kraja: Nuk besoj në mision të tilla të letërsisë, së paku jo deri tani, sepse letërsia projekton një botë ideale, kurse politika shpesh fshihet nën "lëkurën" e saj. Ta zëmë, letërsia serbe është përplot vepra që ngjallin urrejtje për shqiptarët, teksa ju në Shqipëri i përktheni dhe i botoni edhe ata autorë. Të tjerët nuk e bëjnë këtë. Kozmopolitizmi juaj shpesh është i zvjerdhur, një gjellë bajate që nuk ha askush. Më anë tjetër, më duhet t'ju them se në kontekstin ballkanik letërsia shqipe nuk funksionon aq mirë: kryesisht përkthehen vepra të dobëta, jopërfaqësuese.

Jeton Neziraj: Letërsia, duke qenë e lirë, duke qarkulluar lirshëm, duke u shkruar e duke u zhvilluar e duke komunikuar përtej 'kufijve gjuhësor', ajo po, shërben dhe bëhet edhe mjet paqeje, edhe mjet emancipimi e iluminimi social, politik e kulturor, por edhe mjet transformimi i shoqërisë. Pra, s'kemi pse i ngarkojmë mision "paqeje", si qëllim në vete, sepse letërsia e mirë, letërsia që shkruhet në shoqëri të lira, e aspiron paqen vetvetiu, dhe shumë më tepër...

Nikola Madzirov: Një lloj tjetër nervozizmi, ai i kujtimeve personale, lidhet ngusht me letërsinë. Vdekja nuk është një horror i paparashikueshëm në luftë; është vetëm një dashnor. Më shpesh se vitet e kaluara me veten dhe dashuritë e tij, babai im ka folur për kohën e tij në ushtri. Ai fliste me një trajtë vuajtje të ndarë, dhe mund të shihja tatuazhe frike në lëkurën e tij me çdo mendim. A mund të spekulojmë naivisht për pasjetën, edhe nëse nga aty nisin bombat, dhe trajektorja e rënies së lirë të lirisë? "Askush s'do të fluturojë për në qiell", shkruan Zbigniew Herbert te "Lufta". Plumbi dhe mishi tërhiqen nga toka. Një zog i gjallë në trupin e vdekur të një ushtari apo një zog i vdekur në pëllëmbë, përfaqësojnë goditjen përfundimtare të lirisë. Edhe pasi shfaq luftëra të brendshme të padukshme, letërsia sjell paqe. Në poezinë e tij "Një nuse ushqen foshnjën mes të ikurve", Visar Zhiti shkruan, "...Qumesht thithin tragjedite/ me buzët e jetës / duar skeletesh shtrëngojnë gjirin më të madh se paqja...". Tragjedia dhe paqja nuk mund të krahasohen me qëndrueshmërinë e letërsisë.

Nurie Emrullai: Letërsia po të ekzistonte sipas kufijve shtetëror, paramendoni sa e vogël, sa e trishtë, sa e coptuar do të ishte.

Jo vetëm që letërsia duhet të shërbejë si mjet paqeje, por duhet që ne të bëhemi të vetëdijshëm se çfarë po na trumbeton ajo. Të gjithë po sillemi rreth boshtit të njëjtë, që po na rrotullon në vorbullon e gjërave të njëjta. Letërsia është ajo që shfaq njerëzoren tonë, atë që shpesh mundohen të na shtypin apo të na e pushtojnë.

Duke qenë se letërsia nuk është asgjë



Kalin Terziyski

më shumë se sa kombinimi i këtyre 36-të shkronjave, apo dikund mund të bëhet kombinimi i 25-së apo 27-të prej tyre, nuk është e rëndësishme se sa. Se vetë fjala letërsi do të thotë diçka e krijuar prej shkronjave. Ndërsa, tek ne ballkanasit sa shumë është përdorur fjala barbar që etimologjikisht vjen nga fjala "bërbër", që do të thotë i pakuptueshëm apo i paartikulluar. Pra, sigurisht që sot falë përkthimit, letërsia bëhet urë që lidh të njëjtat paradigma njerëzore.

Stefan Çapaliku: Fillimisht zakoni e do që t'i jepet përgjigje pozitive kësaj pyetje. Por ne nuk jetojmë vetëm brenda bibliotekave të së sotmes apo aq më pak të së ardhmes. Bibliotekat tona kanë brenda vetes gjithfarë librash. Pra pyetjes suaj i duhet dhënë përgjigje rast mbas rasti.

Në parim është e padyshimtë që duhet të ndodhë kësaj, pra jo vetëm letërsia e sotme duhet të mbjellë paqe, por edhe letërsia e djeshme nëpërmjet një mendimi të shëndoshë kritik, sepse siç thotë edhe George Orwell "të gjithë kafshët janë të barabarta, por disa janë më të barabarta". Pra që të mos jeshë i barabartë dhe të kthehesh në një faktor emancipues, ka qenë në jetë të jetëve misioni i një shkrimtari të mirë.

Është tashmë e qartë se vepra të kontaminuara nga helmet e urrejtjes s'para kanë pasë dhe s'para kanë gëzuar simpatinë e lexuesve mendjehapur.

A mund të biem dakord dhe të jemi në një mendje se letërsia jonë është më e bukur se historia jonë, duke e tejkaluar në përgjigje cliche-në e zakonshme se janë dy gjëra që s'mund të krahasohen?

Drago Jančar: Historia është ajo që është. Shkrimet e mia rreken të kuptojnë gjithkënd, nuk ka rëndësi në cilën anë të historisë së trazuar të shekullit XX e kanë gjetur veten. *O histori, çrregullimi i verbër i njerëzimit* thotë poeti sloven Edvard Kocbek. Të përshkruash dhe të provosh të kuptosh këtë çrregullim njerëzor – kjo është e bukura e letërsisë. Nuk është më e bukur se historia, bukuria e saj qëndron në kuptimin



Mehmet Kraja



Jeton Neziraj

e brishtësisë së qenies njerëzore dhe destinit të tij.

Dragan Velikić: Nuk mund të krahasohen, sepse ata shkartin njëra me tjetrën, nuk ekzistojnë të ndara. Nuk di që historia e ndonjë vendi të jetë e bukur pa tragjedi dhe shkatërrime. Ndoshta vetëm eskimezët në Grenlandë kanë një histori të qetë, pasi e imagjinoj Grenlandën si një heshtje e thellë. Veprat më të mëdha letrare nga Homeri te Joyce janë të frymëzuara nga luftat dhe perzekutimet, tradhtitë dhe hakmarrjet, por në të njëjtën kohë frymojnë me forcën dhe nevojën njerëzore për drejtësi dhe dashuri.

Kalin Terziyski: Nëse bëhet fjalë për historinë - historia duket si diçka që nuk ekziston realisht - ose të paktën jo tamam si e paraqesim - ajo është një masë e madhe amorfe me fakte "të ndodhura" - në fund të fundit - histori është edhe ajo e para disa muajve, me vajzën që hante akullore, por kaushi u copëtua dhe akullorja ra në tokë. Po - nëse dikush thotë se kjo nuk është thelbësore dhe "histori" është vetëm takimi i dy budallenjve të moshuar që janë kryetarë shteti - nuk do të pajtohem.

Shikoni këtu - historiografia ose le të themi - shkenca historike - kjo është tjetër gjë. Është një mjet i qeverisë për të manipuluar njerëzit. Asgjë më shumë se kaq. Dhe ne - të mësuar të besojmë se e vërteta është një gjë e mirë - mendojmë se manipulimi i popullit është i shëmtuar dhe imoral. Kush jemi ne? - do pyesni ju. Epo, unë dhe macja ime. Emri i saj është Angela. Angela Merkel. (sepse ben mrrrr). Pra, letërsia - kur nuk harron se është më e pasura nga të gjitha artet - është gjithmonë më e bukura.

Mehmet Kraja: Mirë, nuk e do klisheën e pamundësisë së krahasimit, atëherë duhet ta pranosh faktin se letërsia është fiksjon dhe në çdo rrethanë fiksjonet janë projeksione imagjinare, kurse historia është ndodhi reale. Pra, është krejt normale që projeksionet imagjinare të jenë më të bukura se ajo që na ka ndodhur në të shkuarën e largët ose të afërt. Por, në Ballkan

historitë më të besueshme ende i shkruajnë shkrimtarët.

Jeton Neziraj: Është thënë shpesh, rajoni ynë ka prodhuar më shumë histori sesa që ka mundur të konsumojë. Letërsia jonë mund të jetë më e bukur sesa historia, dhe duhet të jetë, por në fakt, duhet poashtu të themi se letërsia në këto anë asnjëherë nuk ia ka dalë t'i bëjë karshillëk serioz historisë, t'ia ndrojtë kursin apo t'ia diktojë rrugën. Historia ka qenë gjithnjë më kokëforte dhe letërsia e ka përcjellur me ndërprerje, herë duke e pasqyruar turbull, herë duke e deformuar e herë duke e glorifikuar. Pra ka qenë një lloj rruge jo fort e lavdishme e bërë së bashku.

Nikola Madzirov: Këtu, edhe para se të bëhet e tashme, e ardhmja bëhet histori.

Nurie Emrullai: Ne jemi Sagë Ballkanike. Duke qenë se fjala Sagë do të thotë Rrëfenjë apo Përrallë. Shkrimtari Luan Starova e përthekon mjeshtërisht në veprën me të njëjtin titull. Pra, ne jemi Sagë, në të cilën lundrojmë ishujve të kujtesës për të mbajtur mend letërsinë e cila ishte dikur, por sot është zvogëluar në pjesë më të vogla, më të imta. Është si fonema pa të cilën nuk formojmë fjalën që me të kemi ndërtuar, por pikërisht me atë fjalë nuk mund të ndërtojmë as diçka të re...

Letërsia, për fat të keq historinë nuk e ka pasur gjithnjë në krah, por ajo ka arritur të thotë ato gjëra që historisë i është ndaluar t'i tregojë.

Stefan Çapaliku: Politikisht përpjekjet tona të përbashkëta të shikuara nga perspektiva nga më të ndryshmet nuk janë asgjë më shumë sesa lëvizje për t'u shkëputur nga e kaluara, nga historia pra.

Kulturalisht punët qëndrojnë ndryshe sepse duhet të bëjmë mirë dallimin midis dy koncepteve bazë të cilat e përshkruajnë dhe e përfshijnë jetën e një shkrimtari ballkanas. Shkrimtari jeton dhe banon. Zakonisht ai jeton në një vend, qytet, shtet, të caktuar të Ballkanit dhe banon në kujtesën dhe dëshirat e veta. Shpesh këto dy realitete, pra ai i trupit (fizik) dhe ai i mendjes (shpirtëror) nuk përputhen me njëri-tjetrin.

Cili është roli shoqëror që ndjeni apo keni ndërmarrë si shkrimtar në shoqërinë ju jetoni, punoni e mbi të gjitha shkruani?

Drago Jančar: Ishte një kohë kur i isha dedikuar demokracisë, lirisë së shprehjes dhe të drejtave të njeriut. Tani parapëlqej të fokusohem në pyetjet më të thella të ekzistencës njerëzore. Dhe kjo do të thotë të jesh në skajet e shoqërisë. Por ku është skaji dhe ku është qendra?

Dragan Velikić: Asnjëherë nuk kam marrë ndonjë rol. Shkrimtari përherë prezanton veten.

Kalin Terziyski: Unë kam mbaruar studimet për mjekësi dhe kam punuar si mjek para se të filloj të shkruaj - dhe në fakt - shkruaja edhe kur isha mjek. Dhe në fund të fundit - unë jam mjek edhe tani. Mendoj se ky është roli im. Mjek - vëzhgues dhe ekzaminues i simptomave - diagnostikues. Mjek - shërues - si i individit ashtu edhe i shoqërisë. Mjek - statisticien. Mjek - prognostikues. Dhe gjëja më e rëndësishme: Mjek-ngushëllues. Një nga romanet e mia quhet *Ushtar*. Por nëntitulli është *Shpresë për të dekurajuarit*. Ky roman ka të bëjë me kërkimin e kuptimit. Njeriu është ushtar kundër pakuptimësisë. Shkrimtari - aq më tepër. Ai është një mjek ushtar, një luftëtar kundër pakuptimësisë.

Mehmet Kraja: Dikur kam qenë aktiv në politikë, në fillim të viteve '90 isha ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të



Nurie Emrullai



Stefan Çapaliku

Kosovës, një kohë mbajta në Tiranë zyrën e Kosovës, më pas ika nga politika, i tmerruar sa shumë korrupsion dhe ndërgjegje të shkatërruara kishte brenda saj. Pas vitit 2000 u mora me publicistikë, godita rëndë fenomenet shoqërore dhe kulturore të shtetit të sapothemeluar të Kosovës. Pasojat e këtij qëndrimi kritik i ndjej akoma. Tani, pozita e kryetarit të Akademisë së Kosovës më ngarkon me përgjegjësi të tjera...

Jeton Neziraj: Nuk konsideroj që kam ndonjë rol tjetër përtej atij të të qenurit 'shkrimtar aktiv', më specifikisht, dramaturg aktiv, që është i lidhur ngushtë me të bërit teatër. Nga ky pozicion (dhe i çliruar nga ndonjë barrë e të pasurit ndonjë rol), natyrisht, e kam të qartë që letërsia, e sidomos teatri, nuk është aty sall për 'kalërim estetike', por një medium artistik me të cilin ne projektojmë vizionet tona, dilemat, shpresën e frikën mbi shoqërinë, mbi politikën, mbi botën... Dhe duke qenë zotërues i kësaj "hapësire ideologjike" që si shkrimtar e kam në dispozicion, unë natyrisht jam i përgjegjshëm, përipiem të jem i përgjegjshëm. Dhe ja këtu vijmë te roli i vetëm që ndoshta mund t'i ngarkohet shkrimtarit: të jetë i përgjegjshëm.

Ndikimi në publik i një shkrimtari nuk është për tu injoruar, sepse njerëzit shpesh preferojnë të "vërtetohet letrare", para të vërtetave që u serviren nga historianët, nga politikanët, nga mediat e nga të tjerët... Në një kohë të "post-truth", për plot njerëz të humbur në informacione, e vërteta gjendet vetëm në letërsi! Dhe ky është një lloj pushteti që letërsia vazhdon ta ketë, akoma...

Nikola Madzirov: Të jetosh në Ballkan do të thotë të lundrohesh kufij, qofshin fizikë apo të imagjinuar nga atlase modernë. Më shpesh se sezoni pjellor i bimëve apo dinamikat e urrejtjes së imponuar nga historia, kufijtë kanë lëvizur në Ballkan. Kur isha fëmijë, kujtoj se si im atë na kërkonte të heshtnim kur kalonim kufirin. Nuk jam i sigurt nëse heshtja ishte prej respektit për uniformën e policit apo nga kuptimi i përgjithshëm për ritualin e kalimit të kufirit. Beteja ajrore përmes frekuencave të stacioneve të

radiove të ndryshme shtetërore luftoheshin përgjatë kufijve, ku një heshtje e tillë ishte më e fuqishme. Kur isha në një kalim kufiri, doja të mos kuptohesha nga askush dhe uroja të mos kuptoja gjuhët. Kjo gjuhë e re e cila shprehej në heshtje me tingullin rastësor të stampimit të pasaportës, ishte shembulli më i gjallë i pranisë në koleksionin e kthimeve në vetvete. Që të mbjellë farat e tëhuajëzimit, poeti kalon kufijtë e ngritur nga luftërat.

Nurie Emrullai: A nuk vazhdojmë ne ende të jemi poetët që Platoni urdhëronte të dëbohen? Sigurisht që po. Por a mundet që shpirti të gatuhet në formë tjetër? Dihet dhe kjo që jo.

Shkrimtarët në çdo kohë kanë pasur rol të veçantë, në çdo periudhë kohore. Kanë qenë shpëtimtarët e gjuhës, mundësuar ruajtjen e identitetit kombëtar.

Ndaj, çfarë roli kam unë në shoqëri, është diçka që e shoh tani për tani larg vetes, ose është shumë thellë meje. Por, në një retrospektivë jo shumë të largët, kujtoj veten se çfarë kërkoja nëpër veprat që merrja t'i lexoja. Unë që çdo herë ia kam pasur nevojën një fjale, një zëri, dikush që të ma lexonte mendjen njëkohësisht që isha unë duke e lexuar atë.

Ndaj, nisur nga ky fakt, nevoja thelbësore e njeriut është të kuptuarit. Të kuptuarit në thelb, aty prej ku burojnë gjithë dhuntitë e marrëzitet njerëzore, aty ku frikësohet njeriu se është i vetmi që është afër atij zgripi, e mu aty do të doja të rrinte poezia ime, sepse prej aty dhe është krijuar, për t'i thënë njeriut, që nuk është vetëm në mbretërinë e Kronosit, që një ditë, domosdo një ditë, do t'i gjëlltisë fëmijët e tij.

Stefan Çapaliku: Padyshim që kur shkruaj nuk kam parasysh vetëm lexuesin e lagjes sime dhe as të qytetit apo vendit tim. Projektoj një kokën time një antropomorf shumë herë më universal me të cilin dialogoj, të cilin e kam frikë, i mas temperaturën dhe i përlogaris durimin. Sfidat ime është që ta kënaq homo urbanusin tim. Ky homo urbanus e përfshin dhe e inkludon edhe homo balcanikus-in tim.



Nikola Madzirov

Paneli II i ExLibris Forum "Kufijtë e letërsisë në Ballkan" Mbi përkthimin e letërsisë ballkanike

Milena Selimi është gazetare, përkthyes, skenariste dhe shkrimtare shqiptare. Ajo ka përvijë menaxhimi në media si "Radio Tirana", "Gazeta Shqiptare", revistat "Kult" dhe "Jeta". Selimi ka qenë Këshilltare për Mediat dhe Komunikimin në Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë në vitet 2013-2019. Ka bashkëpunuar në organizata kombëtare e ndërkombëtare si korrespondente, koordinatore, moderatore dhe anëtare jurie në fushën e gazetarisë, filmit dhe kritikës si: European Theatre Prize, Tirana International Film Festival, Çmimet "Kult", Festivali "Poeteka", Balkan Media Magazine, etj. Është autore e disa pjesëve teatrale për fëmijë, të cilat i ka vënë në jetë në skenën e Teatrit "Metropol" në Tiranë, në periudhën 2010-2012. Ajo ka përkthyer në shqip autorë bashkëkohorë të letërsisë ballkanike, si: Nikola Madzirov, Georgi Gospodinov, Alek Popov, Edo Popović, Milen Ruskov, Ognjen Spahić, Vladan Matijević, Lidija Dimkovska, etj. Milena Selimi ka qenë fituese e "Eurodrame 2019" me dramën e përkthyer nga Goran Stefanovski dhe Tena Tena Štivilić. Ajo flet dhe shkruan shumë mirë në bullgarisht, italisht, maqedonisht dhe serbisht. Ajo ka qenë pjesëmarrëse në aktivitete dhe panele të ndryshme që lidhen me zhvillimet e gazetarisë, dramaturgjisë dhe përkthimit, brenda dhe jashtë vendit.

Nikollë Berisha: Përkthyes dhe autor. Ai ka përkthyer nga gjuha sllovene në shqip autorë me peshë si: Simona Semenič, Milan Dekleva, Janja Vidmar, Gabriela Babnik, Milan Jazbec, Tadej Golob dhe Drago Jančar. Në slovenisht ka përkthyer nga gjuha shqipe autorë si Ismail Kadare, Millosh Gjergj Nikolla, Qerim Ujkani etj. Gjithashtu ai është autor i disa veprave letrare dhe joletrare si fjalori dygjuhësh "Slovenisht-Shqip, Shqip-Slovenisht". Në vitin 2013 është vlerësuar me çmimin ndërkombëtar "Pretnar Aëard" dhe mban titullin honorifik si Ambasador i Letërsisë dhe gjuhës sllovene dhe kulturës sllave.

Ben Andoni është gazetar, përkthyes dhe aktivist i njohur, i cili është lindur në Tiranë. Prej vitit 1996 ai punon si gazetar dhe përkthyes i gjuhëve sllave. Ka shkruar për gazeta, si: "Koha Jonë", "Gazeta Shqiptare" dhe "Korrieri", ka qenë kryeredaktor i revistës "ABC" dhe zëvendëskryeredaktor i revistave "MAPO". Për shumë vite ai ka qenë korrespondent i agjencisë së lajmeve "BETA" të Beogradit. Si publicist, ai shkruan për botime periodike kombëtare të Kosovës. Ben Andoni përkthen në shqip nga serbishtja, kroatishtja, gjuha boshnjake, gjuha malazeze si dhe nga anglishtja.

Russana HRISTOVA BEJLERI, në vitin 1986, mbaroi studimet në Kolegjin Anglez në Sofje, më 1991 mbaroi studimet në Filologji shqipe në Universitetin Shtetëror të Shën Peterburgut në Rusi, ndërsa studimet doktorale i mbaroi më 1995 në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë. Në vitin 2000 filloi punën në Universitetin e Sofjes "Sh. Kl. Ohridski" si profesore dhe gjuhës dhe letërsisë shqipe ku punon edhe sot. Nga viti 2013-2017, drejtoi Departamentin e Gjuhësisë së Përgjithshme në Universitet, ndërsa nga viti 1991-2000 punoi në Radion Bullgaria në emisionin në gjuhën shqipe. Përveç si ligjëruese, Hristova Bejlери është e njohur përmes punimeve (mbi 50 të tilla) të shumta shkencore në fushën e letërsisë dhe albanologjisë dhe librave letrarë: Letërsia shqipe si pasqyrë e karakterit kombëtar Sofje 2009, Fjalori frazeologjik ballkanik (bashkëautore) Tiranë 1999, Albanian Identities (bashkëautore) Sofje, 2000. Po ashtu, ka përkthyer veprën e shumë autorëve shqiptarë në gjuhën bullgare, ka krijuar dhe mirëmban faqen e internetit për albanologjinë në Bullgari www.albanianbg.com.

A është në nivelin e duhur komunikimi ndërletrar mes letërsisë së shkruar në një nga gjuhët e ballkanit (si gjuhë dhënëse) dhe gjuhës shqipe (si gjuhë pritëse)?

Milena Selimi: "Unë dua t'ju them diçka. Por kam harruar çfarë" - shprehet për Ballkanin dramaturgu i Maqedonisë së Veriut, Dejan Dukovski, dramën e të cilit, "Fuçi Baruti" jam duke e punuar në këtë kohë. Përgjithësisht, Ballkani është plot drama. Kjo nuk do të thotë automatikisht letërsi e mirë, por do të thotë se letërsia ka patur dhe ka gjithmonë një rol të rëndësishëm në jetën e këtij rajoni. Letërsia është një gjë e gjallë; ka gjithmonë aftësinë për një reagim të shpejtë ndaj ngjarjeve të jashtme.

Letërsia ballkanike e kohës së sotme ka autorë të shkëlqyer që gjithmonë mund të zbulojnë një krizë të përgjithshme në kohën e duhur dhe mënyrën e duhur, për të patur një fokusim të hollë të problemit, për të paraqitur komplekse dhe personazhe të dallueshëm, dhe që stili dhe nënshkrimi i rrëfimit të jetë emocionues dhe i freskët. Kur flasim për komunikim ndërletrar nga gjuhët e ballkanit në gjuhën shqipe i pari që mundëson komunikimin është përkthyesi.

Shpesh harrohet se përkthyesi është një kufitar me shumë kuptime të kësaj fjale. Ai vetëkrijon kufirin përtej të cilit kalon plaçkën e tij. Ai i ngjan lundërtarit, varka e të cilit lundron nëpër detin e trazuar drejt bregut "tjetër". Shqipëria ka një mungesë të madhe në drejtim të investimit të këtij 'lundërtari ballkanik' që mund të sjellë këtej kufirit kultura, civilizime, ngjarje dhe mjeshtëri shkrimi.

Sipas një raporti të fundit të TRADUK-it,

rrjetit të krijuar në vitin 2008, që me anë të librave, përkthimeve dhe projekteve letrare lidh Europën Juglindore me letërsinë e vendeve gjermanishtfolëse, si dhe letërsinë e vendeve të Europës, përkthime nga gjuhët e Ballkanit në shqip, mbështetur nga ky rrjet janë 32 tituj, nga 16 përkthyes, shpërndarë në 8 shtëpi botuese në të gjitha trevat shqipfolëse, pra flasim për Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut dhe 22 autorë shqiptarë të përkthyer në gjuhët e Ballkanit. Nëse mbajmë parasysh ndonjë botim tek-tuk të shtëpive botuese që kanë një interes për ndonjë autor të veçantë të rajonit, apo programin Creative Europe, kësaj shifre ndoshta mund t'i shtohen edhe rreth 10 tituj të tjerë. Besoj është qartësisht i dukshëm niveli i komunikimit. Pra, në 32 vite të hapjes së kufijve, niveli i komunikimit me autorët e rajonit shkon diku tek një autor në vit e në rastin më të mirë edhe në dy. Por, dua të nënvizoj se autorët e ardhur në shqip janë autorët më në zë të vendit të tyre dhe me njohje e vlerësime ndërkombëtare. Falë këtij bashkëpunimi ne kemi në shqip autorë të shkëlqyer si: Dragan Velikić, Georgi Gospodinov, Alek Popov, Nikola Madzirov, Kalin Terziyski, Vladislav Bajac, Vladimir Arsenijević, Saša Ilić, Šalamun Tomaž, Drago Jančar, Lidija Dimkovska, Andrej Nikolajidi, Dubravka Ugrešić, Daša Drndić, Edo Popović e shumë të tjerë, të cilët përmes një vëzhgimi të hollë na sjellin stereotipet ballkanike sociale dhe kulturore, dashurinë dhe shpresën e paplotësuar të Ballkanit, por edhe një përpjekje për diçka të ndryshme. Këta autorë e zhvillojnë letërsinë kryesisht nga perceptimi 'perëndimor' i Ballkanit, duke mos harruar se kjo hapësirë është vulosur në kodin gjenetik të secilit rrëfim.

Një kod që skalit absurditetin e të jetuarit, që gjithmonë përfundon me drama, një akt hakmarrjeje, afekti, padurimi. Ndonjëherë shoqëria, mjedisi, ndërjegjja kolektive apo e pandërgjegjshme nuk arrijnë t'i regjistronë këto kriza. Letërsia mundet dhe ne e kemi këtë deriçkë të Ballkanit me këta autorë të shkëlqyer.

Nikollë Berishaj: Definitivisht mund të them se komunikimi ndërletrar në mes të këtyre letërsive nuk është i mjaftueshëm. Jeta e përbashkët në ish Jugosllavi ka imponuar njohjen, gati të domosdoshme të gjuhës "zyrtare" serbo - kroate, me këtë edhe një komunikimin, qoftë edhe të njëanshëm kur bëhet fjalë për shqiptarët në atë shtet. Të qenit oaze gjuhësore e kanë përjetuar jo vetëm shqiptarët, por edhe slovenët, e në një masë më të vogël, për arsye të afërsisë më të madhe gjuhësore të maqedonishtes me serbo-kroatishten. Edhe përkthimi i këtyre letërsive ka shkuar në drejtim të serbo-kroatishtes.

Pas shkatërrimit të dhunshëm të Jugosllavisë, u desh sërish të vendosen urrat, nëse jo krejtësisht të rrënuara, së paku të dëmtuara dukshëm. Te shqiptarët na paraqitet një situatë dualiste aspak e lakmueshme. Rrëzimi i sistemit monist në Shqipëri hap një etje të madhe për njohjen e letërsive botërore, deri atëherë të cinguar, të censuruar, "të ndaluar". Është e kuptueshme që përparësi u dha letërsive "të mëdha" botërore. E them "të mëdha" (në thonjëza), ngase jam më se i bindur se nuk ekzistojnë letërsi të mëdha dhe të vogla- përpos për nga numri i krijesve dhe lexuesve- por asesi edhe për nga cilësia.

Në anën tjetër të asaj situatë dualiste kemi në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit të kaluar dhe dhjetëvjetëshin e parë të shekullit aktual, Kosovën, që përpëlitej në grahmat e dhunës dhe krimeve serbe ndaj shqiptarëve, kur nuk mund të mendohej për kulturën...

Në këtë situatë ia ofrova lexuesit shqiptar një dritare të re, të panjohur deri atëherë (në Shqipëri flas), letërsinë slovene. Për fat të mirë, ndër botuesit tanë hasa në një mirëkuptim dhe gatishmëri të madhe për të. Pa përjashtim: *Toena, Dituria, Uegen, Pegi*, Poeteka, së fundmi edhe *SHB Dritan* botuan me kënaqësinë e madhe autorë dhe vepra nga kjo letërsi. Për fat të keq, jam nga përkthyesit e rrallë, në mos i vetmi në këtë drejtim. Do të ishte më mirë të kisha edhe "kolegë" të tjerë. Besoj se letërsia slovene nuk është më e panjohur e plotë për lexuesit shqiptar. Veçanërisht nëse flitet për emrat si: Drago Jançar, Boris Pahor, Slavko Pregl, Simona Semeniç, Milan Dekleva, Gabriela Babnik, Tine Golob ... Me botuesin kosovar *Qendrën Multimedia të Prishtinës* kisha, ndër kohë, edhe tri botime nga kjo letërsi.

Ben Andoni: Rëndësia që i është dhënë në ditët tona komunikimit nuk ka mbetur pa prekur edhe letërsinë, në një aspekt, që ju e përcillni me konceptin ndërletrar. Tashmë, komunikimi si disiplinë ka treguar se është pjesa kryesore e ekzistencës së njerëzimit. Mënyra sesi vazhdon komunikimi në letërsinë ballkanike, personalisht do ta konsideroja si të lidhesh në kushtet e një "komunikimi të nderë". Që do të thotë elementët bazë të komunikimit kanë qenë e mbeten të privuar pasi, një ose disa elementë të tij kanë qenë e mbeten të kufizuar, që do të thotë komunikimi nuk ka qenë i mundshëm. Nëse do të flasim për rastin e ish-Jugosllavisë, komunikimi ynë ndërletrar përshfaq dy fytyra. Është ajo e trevave shqiptare në ish-Jugosllavi, që duke nisur nga pas vitet '90 e në vitet në vazhdim u shkëputën nga Federata, por që ndërkohë përcillnin të gjithë krijimtarinë e hapësirës jugosllave dhe ishin lexues të mirë në origjinal të çdo gjëje të shkruar dhe

Milena Selimi



madje ka edhe shumë ndikime prej kësaj letërsie në autorët shqiptarë që shkruanin; kemi edhe rastin e Shqipërisë, kur letërsia e ish-Jugosllavisë deri në mesin e viteve '90 ishte fare pak e njohur, teksa pas kësaj kohe deri në ditët tona shumë përfaqësues të njohur të letërsisë serbe, boshnjake, kroate, slovene, malazeze e maqedonas janë sjellë në shqip. Nuk ndodh e njëjta gjë në Republikat e ish-Jugosllavisë, ku kemi pak autorë tanët, ndërsa vazhdon që interesi të mbetet për Kadarenë dhe fare pak për autorë të tjerë. Edhe pse ekziston katedër e shqipes në Beograd, edhe pse në Republikat e tjera të ish-Jugosllavisë ka struktura që merren me shqipen, komunikimi ndërletrar është i vakët. Nuk njihen trendet e kulturës shqiptare, autorët që i përfaqësojnë ato dhe, mbi të gjitha përfaqësitë tona diplomatike nuk janë fare të interesuar të shtojnë rrethin e njohjes për shqipen dhe letërsinë e saj.

Në Shqipëri ka qenë e kundërta. Për shkak të ndihmës së "Traduki-t", Ministrisë serbe të Kulturës dhe fondacioneve të ndryshme të huaja janë përkthyer shumë autorë të hapësirës ish-Jugosllave, megjithatë pak individë që merren me letërsi e rrethe kulturore (nëse ky është termi i duhur) kanë njohuritë e duhura e të thella për këtë letërsi. Bëjnë përjashtim njohjet e disa autorëve sllavë që kanë renome ndërkombëtare, që duhet të përshtaten në kurrikula dhe nga ata që i japin në lëndët e letërsisë ballkanike. Nëse do ta përmbledhja me pak fjalë: Është shumë komunikim i vakët me asimetri të theksuar: Njerëzit e kulturës së ish-Jugosllavisë nuk njohin fare pjesën sasiore dhe dinë pakëz atë cilësore



Rusana Bejleri

të letërsisë sonë, kurse ne kemi njohje të emrave që do të thotë letërsinë sasiore dhe pak më shumë atë cilësore.

Rusana Bejleri: Letërsia klasike bullgare është përkthyer në shqip në vitet deri në vitet '80 dhe mund të gjendet në biblioteka akoma me dëshirë të mirë. Pas viteve '90 procesi nuk ka qenë konjektiv. Ekziston një antologji të poezisë bullgare në përkthim të Myzafer Xhaxhiut të vitit 2001 (*ShB Dudaq*) e cila është mjaft reprezentative.

Aktualisht përkthyesja e vetme e letërsisë bullgare në shqip është Milena Selimi. Ajo ka sjellë në shqip autorët kryesorë që janë në zë dhjetëvjeçarin e dytë në Bullgari edhe janë reprezentativë jashtë saj.

Mundeni dot të identifikoni problematika të këtij komunikimi dhe të sugjeroni zgjidhje të mundshme, edhe po qenë ato përtej jush?

Milena Selimi: Kambanat e alarmit për letërsinë e Ballkanit kanë shumë kohë që bien, por nuk i sheh dhe dëgjon askush. Jemi vonë. Jemi shumë vonë. Kemi humbur kaq shumë nga kultura e rajonit. Problematikat nisin siç u shpreha edhe më lart me mungesën e përkthyesit profesionist nga këto gjuhë, mungesën e vëmendjes nga institucionet e kulturës, mungesën e programeve të përbashkëta ballkanike.

Investimi i parë, i munguar dhe i rëndësishëm mbetet investimi në gjuhët ballkanike, duhet të ketë nxitje dhe ndërgjegjësim të katedrave të gjuhëve në Fakultetin Filologjik në Tiranë, Beograd, Sofje, ku mungon lënda e përkthimit. Nuk kemi përkthyes. Kam patur mundësinë t'i shoh nga afër këto katedra dhe interesi për mësimin e gjuhës shqipe ka filluar të rritet. Shpresat për fuqizimin e nismës "Ballkani i Hapur", që shërben për të injektuar dinamizëm në bashkëpunimin rajonal, në kuadër të tregut të përbashkët, ka rritur kërkesat e studentëve që e shohin si një mundësi të mirë punësimi në të ardhmen. Njësoj edhe në Sofje, në universitetin "St. Kliment Ohridski" ku së fundmi është krijuar një webplatformë e përkthimit nga studentët, që sjellin ekstrakte nga veprat e autorëve shqiptarë në gjuhën bullgare.

Sot kemi programe ballkanike që kanë bërë bashkë institucione të kulturës, shtëpi botuese dhe qendra kulturore, duke krijuar rrjete komunikimi mes Ballkanit dhe Europës, falë projekteve të ndryshme. Por gjithçka mbetet individuale dhe fragmentare në zinxhirin e investimit.

Institucionet e kulturës duhet të krijojnë programe të përbashkëta ballkanike në fushën e përkthimit dhe të gjejnë

instrumentët e duhur për të lëvizur të gjithë ngrehinën e komunikimit ndërletrar që lëviz vetëm në mënyrë fragmentare dhe me paterica. Si përkthyes i kam pritur këto programe, qoftë edhe në kuadër të nismës "Ballkani i Hapur". Nuk ka kohë. Kemi humbur kaq shumë vite dhe emra autorësh në periudha të rëndësishme të kulturës së fqinjëve. Të mos humbim trenin e fundit: Autorët bashkëkohorë të këtij shekulli.

Të mos harrojmë se vendet e rajonit janë më të favorizuara në gjuhë, u përkasin grupimit të gjuhës sllave: serbë, kroate, maqedonas, bullgarë, ata janë të ngjashëm për sa i përket gjuhës që flasin dhe njohin, kështu që investimi i tyre në përkthimin e njëri-tjetrit është më pak i vështirë. Andaj janë të rrallë përkthyesit e interesuar për autorët shqiptarë. Më mirë akoma kemi fatin të kemi përkthyesit me origjinë shqiptare, që jetojnë në shoqëri dygjuhëshe. Shqipja është një gjuhë e veçantë në familjen indo-evropiane dhe investimi në nxënien e gjuhëve ballkanike në Shqipëri duhet të jetë dyfish më i lartë. Nuk flas këtu vetëm për letërsinë, por edhe për studiuesit, hulumtuesit, antropologët, etnografët e muzikologët. Arkivat ballkanike janë të pasura me dokumenta që duhen zbuluar, që i vlejnjë historisë dhe kulturës shqiptare. Për këtë duhen ata, përkthyesit, që i kemi në pakicë. Gjej rastin të falenderoj kolegët e mi për punën e jashtëzakonshme të përkthimit, këta punëtorë të përunjur, që me shumë mund e sakrificë kapërcejnë kufijtë e Ballkanit përmes letërsisë: Janka Selimi Trifonova, Ben Andoni, Virgjil Muçi, Anton Berishaj, Qerim Ondozi, Nikollë Berishaj, Russana Bejleri, Ekaterina Tarpomanova, Merima Krijazi, Dorde Bozovic, Mirjana Jashari, etj.

E fundit, por shumë e rëndësishme duhet theksuar fort se përkthyesi në Shqipëri është në një përpjekje të vazhdueshme mbijetese. Në Shqipëri rriten çmimet e kastravecit dhe letrës higjenike, por jo tarifat për përkthyesin letrar. Shtetet tona ballkanike dhe institucionet përkatëse të kulturës kanë investuar shumë pak përsa i përket fuqizimit dhe vlerësimit financiar të përkthyesit, aq më shumë kur flasim për gjuhë të vogla ballkanike. Platformat evropiane si Creative Europe, rrjetet e ndryshme si TRADUKI dhe grandet e përkthimit nga Ministrinë e Kulturës për gjuhët ballkanike janë mundësia e vetme për të mbajtur gjallë këtë komunikim ballkanik dhe njohje të Tjetrit. Si një përkthyes e Traduki-t prej vitit 2009 them me bindje se ky rrjet ka qenë dhe mbetet për ne paradhoma e Bashkimit Europian, një model integrimi ku shtete që tashmë janë në Bashkimin Europian, madje dhe në krye të strategjisë dhe politikës së këtij organizmi, si Gjermania, gjejnë gjuhën e përbashkët të bashkëpunimit edhe me shtete aspirantë për në BE, si Mali i Zi, Bosnja, Maqedonia, Serbia apo Shqipëria. Kultura mund të ndërtojë ura që politika demagogjike nuk do të ishte e aftë. Njerëzit e dinë, si ata të qendrës edhe ata të periferisë, pyes veten nëse e dinë edhe qeveritë.

Nikollë Berishaj: Problemi kryesor që paraqitet në prezantimin e letërsive ballkanike në shqip dhe anasjelltas para së gjithash është mungesa e mjeteve materiale të botuesve. Të gjitha botimet nga gjuha slovene në atë shqipe që i realizova ishin të mbështetura, ose nga Agjencia Publike e Librit të Republikës së R. së Sllovenisë ose, kohëve të fundit, nga fondacionet Evropiane (Traduki, Evropa krijuese ...). Në Republikën e Shqipërisë, por as të Kosovës nuk kemi një politikë të mirëfilltë për "eksportin" e prodhimit më të vlefshëm shqiptar - letërsisë. Edhe ato pak konkurse që i paraqesin ministrinë e kulturës, kufizohen në një numër ekstremisht të vogël të veprave letrare, duke u dhënë përparësi përkthimeve në gjuhë (përsëri) të "mëdha". Si shembull

i mirë, ministrinë tona do të duhej ta kishin politikën shtetërore të Sllovenisë, që për çdo vit mbështetë dhjetëra e dhjetëra përkthime të autorëve të vetë në të gjitha gjuhët e mundshme.

Posaçërisht do të ishte me vlerë investimi në përkthimet e veprave shqipe në gjuhët e Ballkanit. Kultura është ajo që, më së lehti, i thyen barrierat e moskuptimit, gjegjësisht keqkuptimit dhe atavizmave të gjithmonshëm në marrëdhëniet ndërmjet kombeve ballkanike. Por është shumë me rëndësi edhe përzgjedhja e autorëve. Dikur, në ish Jugosllavi, ishin shpesh kriteret jashtëletrare (më së shpeshti politike) ato që e kandidonin një autor për përkthim. Kështu, për shembull, përkthehej vepra (letrare) e Sinan Hasanit, Fadil Hoxhës..., por sllovenët nuk e njihnin Anton Pashkon, Mirko Gashin, shumë vonë e njoftuan Ali Podrimjen. Madje edhe përkthimet ishin nga serbo-kroatishja. Gjenerali i ushtrisë së vdekur u përkthye nga frëngjishtja!

Fatkeqësisht, vetëm më 2006 u bë përkthimi i parë i Kadaresë (Prillit të thyer, në përkthimin tim) drejtpërdrejt nga shqipja. Parimi im për përzgjedhje është, medoemos të merren veprat dhe autorët më të mirë të një letërsie për përkthim në një gjuhë tjetër. Në atë rast, dobia është edhe e letërsisë dhe kulturës dhënëse, edhe asaj marrëse.

Ngase përkthej edhe në gjuhën serbe-kroate-malaziasë-boshnjake (gjuhë "e njëjtë" me katër emra) edhe aty kam provuar t'i paraqes vlerat tona më të mira, Ridvan Dibrën, Rexhep Qosjen, Ledia Dushin... e në periodikun e këtyre gjuhëve edhe F. Rreshpjen, Arben Idrizin, Xhevdert Bajrën, Agron Tufën...)

Ben Andoni: Problematikat janë të shumta dhe më së shumti vinë me mungesën e theksuar të përfshirjes së duhur të letërsisë bashkëkohore ballkanike në kurrikulat tona në sistemin e mesëm arsimor dhe po ashtu edhe në atë të lartë. Nuk mund të flas për letërsinë greke, sepse ka disa nobelistë, apo atë të vendeve të tjera, pasi nuk e konsideroj veten si të përshtatshëm. Ndërkohë që studiuesit e historisë së letërsisë apo njerëzit e lidhur me të shpeshherë i kthehen problemit të një logjike të re, apo një lloj sistemimi të kurrikulave, përcjellje të segmentuar dhe studimit ndryshe të lëndës së letërsisë, pasi vetëm kështu mund të plotësohen e përmblushen lëshimet e zbrazëtitrat e bëra si në rrafshin metodologjik, ashtu edhe në atë teorik të interpretimit të letërsive tona. Në trojet etnike përveç se në Shqipëri, shtuar edhe në Kosovë dhe në Maqedoni studiohet sipas tre sistemeve të arsimit që punojnë me aktet programore të këtyre shteteve. E nëse atyre do t'i shtohen edhe dy sisteme të Malit të Zi e të Kosovës Lindore, shohim se vetëm në trojet etnike praktikisht janë në zbatim pesë sisteme shkollimi, ndaj edhe hartohen pesë lloje librash mësimore, pra edhe ndërtohen pesë parime të hartimit të plan-programeve të teksteve mësimore.

Një zgjidhje do të ishte që lënda e letërsisë së Ballkanit, sidomos në universitetet tona t'u lihej njerëzve që kanë lidhje me të apo njerëz të saj të ftoheshin më tepër. Po, ashtu në kurrikulat kushtuar letërsisë së Ballkanit në trojet etnike, duhet të kishte një tekst të përbashkët, ku të kishte një lloj hierarchie vlerash, jo thjesht sa i përket autorëve të hapësirës ish-jugosllave që kanë renome ndërkombëtare, por edhe atyre që kanë qenë model ndikimi për autorët shqiptarë. Ndërsa, sa i përket përcjelljes së letërsisë tonë, do të duhej investimi i shtetit përmes antologjive dhe jo vetëm, që autorë tanë të ndryshëm të përcilleshin sistematikisht në tregun sllav dhe mbi të gjitha të ishim prezent në të gjitha aktivitetet e tyre kulturore me statuse ndërkombëtare. Për këtë do të duhej një shkundje e subjekteve



që lidhen me Ministrinë e Arsimit dhe sidomos atë të Jashtme.

Rusana Bejleri: Problemi kryesor është fluksi i madh i informacionit mbi lexuesit potencialë, në një epokë të zbritjes së interesit ndaj leximit të librave në përgjithësi. Zgjidhjet potenciale: Interesimi sistematik i ndonjë shtëpie botimi për letërsinë bullgare, duke u marrë rregullisht me autorë dhe vepra që mund të gjejnë financim në kuadrin e projekteve ose kollanave se bashku me letërsi të tjera (p.sh. ballkanike, sllave etj.). Vitet e fundit ka financime të tilla, mjafton interes konsequent. Zgjidhja e dytë është botimi elektronik i tipit antologjik, i cili do të mundësonte rënien në kontakt rastësisht ose në mënyrë spontan me kulturën tjetër.

Secili vend e shkruan historinë e letërsisë së tij. Ju si ndërtuesit e urave mes letërsive, mendoni se do të ishte gjëja e duhur dhe mbi të gjitha diçka me vlerë shkrimi i një historie të letërsisë ballkanike E shihni këtë si një gjë të mundshme?

Milena Selimi: Ne, në mënyrë të vetëdijshme, e ndajmë memorjen në të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, për të kapërcyer dhimbjen fshihemi pas kujtesës të së sotmes, që të mos kthehemi pas, tek lufta, kufiri, dhuna, dashuria e humbur dhe ikja përgjithmonë e njeriut të dashur. Thënë ndryshe, ne ndihemi më të sigurtë në kujtesën e përbashkët, siç është historia. Ballkani vuan nga mungesa e dyshimit në historitë e përcaktuara dhe tregimet e



Nikollë Berishaj

kemi borxh të Ardhmes një histori letërsie ballkanike. Le ta bëjmë. ExLibris mund ta ndërmmarrë një mision të tillë. Unë jam gati!

Nikollë Berishaj: Do të ishte me interes të madh, por...

Në CV-në time si përkthyes janë edhe dy antologji të letërsisë sllovene: Antologjia e poezisë bashkëkohore sllovene (Toena) dhe Antologjia e dramës moderne sllovene (Qendra Multimedia). Jam i vetëdijshëm se në çdo përpilim të veprave të tilla, mund të ketë edhe subjektivizëm. Në fund të fundit, të gjithë jemi njerëz. Edhe ne!

Një antologji e ngjashme për të tjerët pranë nesh e mbështetur nga një fondacion gjerman u botua në shtatë gjuhët ballkanike dhe në gjermanisht. Nga secila letërsi ballkanike u morën nga disa autorë me tregime lidhur me temën. Unë isha pjesë e realizimit (si përkthyes) edhe në botimin shqip (Toena, "Ata që janë ndryshe dhe që i kemi pranë") edhe në atë sllovenisht (Slovenska matica, "Drugi v bližini"). Por, sa njihet sot kjo antologji. Libri nëse nuk shpërndahet, nëse nuk promovohet, nëse nuk vjen në duart e atyre që duhet ta lexojnë dhe "të mësojnë" prej tij, di të bëhet natyrë e vdekur në një raft biblioteke.

Para disa muajsh Shoqata Rajonale e Shkrimtarëve të Kosovës, Shqipërisë e Malit të Zi "TEUTA" botoi një pasqyrë të poeteshave (të Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi). U prit shumë mirë.

Më mungojnë shumë festivalet ndërkombëtare letrare që aq mirë i shfrytëzojnë kombet tjera për promovimin e kulturës së vet dhe për njohjen e të tjerëve. Në Prishtinë ekzistojnë vite me radhë festivali "Polip", "Ditët e Naimit" në Tetovë, gjithashtu. Vetëm sivjet kishim festivalin e parë të tillë në Tiranë. Aty dëgjohen gjallë gjuhët në të cilat krijohet, ashtu thyhen temat tabu ndërmjet nesh.

Ai... por... që e vendosa në fillim të përgjigjes në këtë pyetje i kërkon të gjitha këto, që nga përpilimi, prej njohësve të mirëfilltë, përkthimi në gjuhët ballkanike, promovimi në të gjitha qendrat dhe gjuhët e deri te shpërndarja e librit në çdo cep.

Ben Andoni: Nëse do t'i referohesha argumenteve të mësipërm, paçka se e vlerësoj shumë pikëpamjen tuaj dhe ekzistojnë tekste për të, e quaj sërish të pamundur. E para se në Shqipëri ka një stigmë për letërsinë e hapësirës sllave. Shikoni me kujdes kur mbledhen juritë, as nuk i referohen librave të kësaj hapësire, kuptohet përveç Ivo Andriq, Sekuliq, Danilo Kish e pak të tjerëve, paçka se ka autorë që janë referencë tashmë edhe në letërsinë bashkëkohore ndërkombëtare. Ndaj, duhet të kemi një cak emancipimi të piramidës sonë zyrtare, që personalisht mendoj se ka ende shumë për t'u arritur. Dhe, shtoj edhe indiferencën e madhe që kanë vendet e ish-hapësirës Jugosllave për letërsinë tonë, pasi njerëzit që duhet ta bëjnë këtë punë janë thjesht burokratë që mbushin raporte shterpë.

Historia e letërsisë në rajon donte individë idealiste dhe të pavarur si Robert Elsie, që ta referojnë si një masë kulturologjike, ku të evidentohen dhënjemarrjet e çdo letërsie, por edhe gjetja e të përbashkëtave si edhe kalimi me shumë ndershmëri i caqeve të letërsive të mëdha, siç janë ato të Greqisë, Rumanisë dhe Republikave të ish-Jugosllavisë me Shqipërinë, ku mbetemi ende falë emrit të krijuar nga Ismail Kadare dhe shumë pak të tjerëve, si Lleshanaku, Leka e pak të tjerë.

Rusana Bejleri: Është sipërmarrje interesante dhe më duket madje më e lehtë sesa botimi i historive të letërsive përkatëse veç e veç po të duhej të bëhej sot, sepse do të kërkoheshin dukuri reprezentative në 2-3-4 letërsi dhe kështu mund të eliminohej trysnia e trajtimit për një publik të parapërgatitur të brendshëm.

... Sofie, nëntor 2008.

Jemi tre miq nga Tirana, në kohë për takimin Je orës 11.00. Pas vizitës në muzeun e poetit Nikolla Vapcarov, ende në restaurim, zbresim në trotuar, kalojmë disa kryqëzime dytësore rrugësh – “Han Asparuh”, “Car Asen”, “Knjaz Boris I”, “Car Samuil” (të gjithë emra princësh e mbretërisht të Mesjetës), për të dalë te kryqëzimet e bulevardëve me trafik të dendur – “Hristo Botev”, “Patriark Eftimij” dhe “Gjeneral M. D. Skobelev”. Te sheshi i Monumentit Rus (“Rúski Pámetnik”) kthejmë majtas te rruga “Gjeneral E. I. Totleben” (emra gjeneralësh rusë të periudhës cariste) dhe gjejmë portën e një ndërtese 4-katshe, të stilit të paraluftës, mjaft i ndryshëm nga stili i ndërtesave me ballkonë të socializmit, në të dy anët e bulevardëve. E kishim lënë, që një buqetë lulesh ta merrnim te dyqani rrëzë ndërtesës. Dyqanin e patëm parë edhe herë të tjera, nga autobuzi dhe tramvaji i linjës andej pari, sepse binte në sy – i bollshëm e i larmishëm brenda dhe jashtë në trotuar – tamam për një buqetë me lule për rastin. I biem ziles te porta. Po i shkojmë për vizitë Thoma Kacorrit, shkrimtar, albanolog, profesor universiteti, kolonjar, “rilindësi i fundit” në Sofie, 86-vjeçar i mbyllur në shtëpi nga sëmundja. Është nëntor 2008, fundi i javës së parë. Në mesin e dhjetorit, domethënë pas pesë javësh, ai do të ndahej nga jeta...

...Thoma Kacorri e pata takuar edhe dy herë të tjera. Hera e parë ishte “takim” me shkrimtarin nëpërmjet veprës së tij, në Shqipëri, në Kavajë, ku në gjysmën e dytë të viteve ’50 pata punuar si shitës librarie. Më 1957, ndër librat e shkrimtarëve shqiptarë të kohës, që duhet thënë se ende numëroheshin me gishtat e duarve, Ndërmarrja e Botimeve “Naim Frashëri”, nga e cila asokohe vareshin librat dhe bëhej shpërndarja e librit, na solli nga Tirana edhe “Jetë në brengë”, përmbledhje me tregime, me autor një emër të panjohur për mua – Thoma Kacorri. Asokohe ata, që lexonin rregullisht, i përpinin librat e rinj. Në tregimet e tij gjallonte jeta fshatare, fryma atdhetare e historisë së Rilindjes. Ishte një frymë që deri atëherë, ndër shkrimtarët e kohës, e kisha ndjerë te Sterjo Spasse. Të paktën kështu m’u duk mua. Nga leximet e tjera më pas mbaj mend romanin “Për mëmëdhenë”, të cilin më duket se e kam lexuar në revistën e përmuajshme “Nëntori”, e që u botua edhe si libër në dy vëllime.

Takimi i dytë ishte sy më sy. Ndodheshim në rajonin “Gorna Banja” të Sofies, në kuadrin e një udhëtimi turistik, të organizuar nga Shoqata “Miqte e Bullgarisë” aty nga viti 2005. Ishim ulur në një nga lokalet e këtij rajoni klimaterik të kryeqytetit bullgar dhe, tek po e prisnim të vinte, pasi kishte pranuar me shumë kënaqësi ftesën për t’u takuar me ne “për një kafë”, disave u vajti mendja se mbase kishim gabuar, që po mundonim një burrë 80-vjeçar e kusur të vinte të bënte goxha rrugë nga shtëpia në qendër të Sofies deri në rrethinat e “Gorna Banjas”. E

2022 është viti i 100-vjetorit të lindjes së Thoma Kacorrit

THOMA KACORRI, I FUNDMI I RILINDASVE

Nga Abdurrahim Myftiu

kishim patur kot. Pamë një burrë të gjatë, që pasi zbriti me kujdes nga makina bashkë me të shoqen, u dha te dera e lokalit shtatlartë e shtatdrejtë, burrë i hijshëm, me flokë të rrallë e të zbardhur nga dëborat e viteve, por me një nur gjakplotë në fytyrë, faqejuq m’u duk, si disa kolonjarë të tjerë, që njihja në Tiranë. Kishte veshur një kostum blu, këmbishë të bardhë dhe kravatë blu, tamam si për festë. Për një çast më erdhi pak zor, sepse ne të tjerët të veshur si për turizëm kishim ardhur. Por ai, sikundër u muar vesh gjatë bisedës, e kishte festë kur shihej me shqiptarë Shqipërie. Me siguri, nuk e mendonte si mund të vinte ndryshe në takime të tilla...

... Dhe ja tani, në këtë ditë nëntori 2008, si u hap porta, shumë të ngjitur shkallët e kësaj shtëpie pranë dyqanit të luleve. Në katin e tretë, te sheshpushimi, na pritë e shoqja, Violeta, një grua e hijshme, njëlloji si herën e parë te “Gorna Banja”. Interieri i shtëpisë – i gjithi në frymë klasike – mbizotëron druri dhe bardhësia e pajisjeve, si te perdet e dritareve me stil të hershëm, ashtu edhe bardhësia në kullm e paqme e krevatit, çarçafëve dhe mbulesave. Mbi jastëkët e paqem luleplotë shndrisin fytyra e paqme, flokët e bardhë, po sidomos buzagazi me të cilën na pret. Thomai është i ngujuar në shtrat, të tre përshëndetemi me të, por zërin e ka të mekur dhe fjalën ia lemë njërit prej nesh, Llukanit, i cili këtu ka ardhur edhe herë të tjera dhe zë të kuvendojë më lirshëm me të, ndërkohë që shoku tjetër, Engjëlli, kameraman, kërkon të mos i shpëtojnë gjestet më të bukura. Përveç optimizmit të Thomait vetë, në këtë mjedis shtëpie e në kushtet e veçanta të tij, mua më mrekullon diçka tjetër: në këtë dhomë gjithçka flet për përkujdesjen shembullore të Violetës, zonjës së shtëpisë, dhe të Linditës, bijës së tyre. Kthej vështrimin përsëri nga krevati, tek sytë, herë ende shprehës e herë si mirazh, të të zotit të shtëpisë. Befas m’u kujtua diçka e mprehtë, që e pata lexuar në një intervistë të tij, dhënë një gazete shqiptare, disa vjet të shkuara. Më kishte mbetur në kujtesë, që veten e kishte cilësuar “mërgimtar të pamërguar kurrë”. Kur u ktheva në Tiranë, gjeta rastin ta verifikoja,

sepse nuk mbaja mend kohën e intervistës. Kishte qenë në numrin e tetorit të vitit 2003, në gazetën lokale “Kolonja”. „Mund të them që fshati, Kolonja, Shqipëria, jeta e kaluar, e sotme apo e ardhmja, janë si një mirazh, një mirazh, që nuk më ka lënë e nuk më lë të qetë, - thoshte në atë intervistë. - Çdo ditë është e pamundur të mos mendoj për fshatin, ku kam lindur, për fshatarët, për jetën që kam kaluar atje... Unë, në qoftë se kam marrë një emër si njeri, si shkrimtar, si studjues, janë pikërisht këto, që më kanë bërë të njohur. Malli për gjithçka më ka mbajtur mërgimtar të pamërguar kurrë. Veç malli më ka bërë të fortë.“

Thoma Kacorri ishte lindur në Shtikë të Kolonjës, më 1922. Me që pak kohë më pas i ati shkon në kurbet në Amerikë, familja shtrëngohet të emigrojë në Sofie para L2B, ku tashmë, qysh në zgrip të shekullit, banonin dajallarët e Thomait 17-vjeçar. I ati u bashkua me familjen shumë më vonë, në fillim të viteve ’70, dhe kjo shtëpi ishte ndërtuar me ndihmesën e tij nga kurbeti. Kurse djaloshi këtu në Sofie vazhdoi shkollën e mesme, e pastaj atë të lartë për drejtësi, në fushën e së drejtës administrative. Njëkohësisht hyri edhe në mesin e asaj kolonie shqiptarësh, që prej kohësh kishin zënë vend në kryeqytetin bullgar. Gjatë gjithë jetës mbante me krenari nënshtetësinë dhe pasaportën shqiptare.

... Violeta e vëren sesi vështrimi im baret në të katër anët e dhomës, edhe te bufeja e komodina plot me ilaçe për Thomain. Ajo gjen një moment dhe më shpie në një kthinë tjetër, me interier po aq klasik – dhe shoh se aty është përsëri Thomai, por tashmë studiues, pedagog, shkrimtar, veprimtar kombëtar. Kjo kthinë është studioja e tij, e mbushur dënga me libra, dorëshkrime, madje edhe të mbetura përgjysëm mbi tavolinën e punës. Te raftet në korniza janë vënë një numër vlerësimesh me çmime e dekorata, ndër to Urdhri “Naim Frashëri”, kl. I, „Për kontribut të shquar në zhvillimin e shkencave albanologjike“, dhe Urdhri “Nderi i Kombit”, i akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë Bamir Topi, me dekretin nr. 5724,

dt. 12. 05. 2008, dorëzuar këtu në Sofie, në shtëpi, para pak muajsh.

Kjo studio mban mbi supë një punë kolosale gjashtëdhjetëvjeçare, në radhë të parë me gjuhën shqipe: lëvruet i saj në vepra letrare, autor tekstesh akademike për studentët vendës të Universitetit „Shën Kliment Ohridski“ të Sofies, bashkautor fjalori bullgarisht-shqip, pedagog i gjuhës shqipe, përkthyes i palodhshëm i letërsisë shqiptare në bullgarisht, albanolog i mirëfilltë me studimet e tij për dukuri të shqipes dhe për marrëdhëniet e saj me gjuhë të tjera, studiues i ndihmesës së emigracionit shqiptar në Bullgari, etj.

Më sipër përmenda dy vepra të tij, të lexuara në Shqipëri, por më duhet të them se këtu, në këtë studio, mësova për një bibliotekë të tërë veprash letrare të Kacorrit, të botuara në Tiranë, Prishtinë, Shkup e Tetovë, jo të gjitha të njohura si tituj prej meje: “Ditë që s’harrohen”(1958), novelë e nderuar me çmim në një konkurs kombëtar në Shqipëri; novela tjetër “Dashuri”; romani “Shpata e Kastriotëve”; “100 Fabula”; “Albania” – në bullgarisht, bashkautor me B. Bobev, përveç veprave të para – përmbledhjes me tregime “Brenga që s’harrohen” dhe romanit “Për mëmëdhenë” (1961-1963). Pranë tyre në këtë studio shoh edhe botime në bullgarisht të prozës së tij, të disa shkrimtarëve të tjerë shqiptarë, dhe nga folklori, si „Mëzhu dve planin visoki“, Sofia, 1979, në bashkëpunim me poetin Marko Gánçev (shq. „Midis dy maleve të lartë“), me pjesë nga “Eposi i Kreshnikëve”, e me këngë popullore lirike, dasmash, ninulla, vaje. Vite më vonë, do të më binte në dorë një libër me figurën e dy luleve manushaqe në mes të kapakut blu: “Romancë dashurie dhe brengje”, poezi. Nuk e dija për poet. Kjo përmbledhje poetike, e botuar në kujdesin e së shoqes pas vdekjes, do të nderohej si më i miri libër poezie i vitit 2011 nga Klubi i Shkrimtarëve “Bota e Re” në Korçë, anëtar nderi i të cilit ishte... Mes librave është dhe “Fjalori Bullgarisht-Shqip”, botim i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë më 1959. Nga kopja e këtij fjalori, që kam në shtëpi, shënoj se fjalori është punuar nga Thoma Kacorri dhe një grup studentësh shqiptarë në Sofie, të mobilizuar prej tij – T. Tartari, L. Dusha, S. Pasko, L. Grabocka, me redaktorë akademik Vl. Georgiev dhe R. Mutafçiev, dhe vetë Th. Kacorri për pjesën e shqipes. Nga rafti marr dhe shfletoj një “Metodë për mësimin e Shqipes për të huaj”, në versionin bullgarisht dhe anglisht, botim i Universitetit “Shën Kliment Ohridski”. Te kjo tavolinë janë hartuar me dashuri e këmbëngulje dhjetra punime për shqipen, libra e artikuj shkencorë, rezultat i hulumtimeve të vazhdueshme në terren dhe në bibliotekat e Bullgarisë, sidomos në Bibliotekën Kombëtare në Sofie e në arkiva. Bares sytë te biblioteka e pasur në vetë këtë studio të ngrohtë të shkrimtarit dhe studjuesit. - Di dhe përdor 6-7 gjuhë të huaja, - më bën me dije zonja e shtëpisë. - Atë çast m’u kujtua ç’më kishte thënë shoku im gjatë rrugës për këtu: nëna e Thomait

Nga vizita në
shtëpinë e Thoma
Kacorrit në Sofje,
nëntor 2008

Thoma Kacorri, në
qendër, i treti nga e
majta.
Violeta, e shoqja, e
pesta nga e majta.

Autori i shkrimit,
Abdurrahim Myftiu, i
pari nga e majta.



Kultura, krahas gjuhës, është komponent shumë i rëndësishëm dhe i pandashëm në çdo përkthim. Përkthyesi, si ndërmjetës i procesit përkthimor, bën kalimin e tekstit jo vetëm nga gjuha në gjuhë, por edhe nga kultura në kulturë, sado të largëta ose të afërta qofshin ato. Nga shkalla e harmonizimit të kuptimit që mbart elementi gjuhësor me kontekstin kulturor varet edhe ciësia e përkthimit.

Kur përkthejmë një vepër letrare, ku autori shpalos potencialin kulturor të kombit të vet, dalin në pah jo vetëm elementet kulturore universale, mbarënjëzore, por edhe shumë fakte, koncepte a dukuri specifike që i përkasin vetëm njëre kulture. Elemente të tilla shënojnë veçori etnonacionale, objekte a dukuri të kulturës materiale e shpirtërore, procese a fakte historike, zakone e rite, të cilat, si rregull, nuk kanë barasvlerës leksikore në gjuhët e tjera. Leksiku i tyre mbart ngjyrimet e theksuara kombëtare e historike, përcjella e të cilave në kulturën pritëse ia vështirëson së tepërmi punën përkthyesit. Në literaturën gjuhësore këto njësi leksikore njihen me termin *realie*, por i gjejmë të emërtuara edhe si *kulturonime*, *ksenonime*, *ekzotizma*, *lokalizma*, *etnografizma*, *historizma* etj. Me ngjyresa të forta kulturore janë edhe një pjesë e njësive frazeologjike, proverbave e fjalëve të urta, të cilat, përveç kulturës që i ka prodhuar, nuk përkojnë me kulturat e popujve të tjerë. Mospërkimet etnokulturore jo rrallë çojnë në gabime përkthimore, në shtrembërime të informacionit ose në cënime të sistemit konceptual të tekstit original. Realiet me ngjyrimet kombëtare kërkojnë vëmendje dhe qasje të veçantë nga përkthyesi, por mbi të gjitha kërkojnë njohje të thellë të dy kulturave dhe dy gjuhëve në kontakt.

Për transmetimin e elementeve kulturore me ngjyresa kombëtare përkthyesit zakonisht ndjekin dy lloje strategjish: a) strategjinë e përshtatjes së realieve kulturore të origjinalit; b) strategjinë e ruajtjes maksimale të të gjitha veçantive kulturore dhe gjuhësore të origjinalit. Të dyja strategjitë kanë anët e tyre pozitive dhe negative. Përshtatja lehtëson perceptimin dhe kuptimin e tekstit nga lexuesi, por kur ajo përdoret pa kriter vepra humbet vlerat artistike dhe origjinalitetin e saj. Strategjia tjetër, e cila synon të ruaj maksimalisht realiet kulturore, idenë dhe stilin e veprës origjinale, e njeh lexuesin me një kulturë të re, por tepria e koncepteve dhe dukurive kulturore, të panjohura për lexuesin e përkthimit, mund ta ndërlikojë perceptimin e tekstit prej tij. Kjo është edhe arsyeja pse përkthyesit detyrohen të shpjegojnë në fund të faqes dukuri të veçanta kulturore të origjinalit. Por edhe shënimet e përkthyesit me tepri, përveçqë mund të rritin në mënyrë të pajustificueshme vëllimin e veprës, e detyrojnë lexuesin të shpërbet shpesh nga teksti e të humbasë fillin e rrëfimit.

Le të shqyrtojmë disa raste tipike nga përkthimet e letërsisë ruse në shqip, ku përshtatja e realieve kulturore sipas shijeve të lexuesit e deformon, e largon shumë përkthimin nga origjinali. Ja disa vargje nga poema e N. Nekrasovit **Kush rron mirë në Rusi** (Vepra letrare 2,137), të përkthyer nga L. Kodra gjatë viteve '50 të shek. XX:


Pa plasi gazi e qejfi! Dy zonjat bukuroshe, Me urdhrin e beut, Fshatarët gostitën Me ver' dhe raki...
Пошло веселье! Барыни, По приказанью барина, Крестьянам поднесли...

Me këto pesë vargje në shqip (nga tri në original) përkthyesi ka zëvendësuar informacionin kulturologjik të origjinalit me elemente të kulturës shqiptare. Në origjinal bëhet fjalë për një cast gëzimi e hareje, ku ca **zonja**, me urdhër të **zotërisë** (jo të beut), gostitën muzhikët me verë e **vodkë** (jo me raki). Në rusisht fjalët **barynji dhe barin** kanë të njëjtën rrënjë (*bar-*), por në rastin e parë fjala jepet korrekt **zonjat**, në rastin e dytë përkthyesi në vend të fjalës **zotëri** ka futur një personazh të huaj për kulturën ruse që mban titullin e periudhës osmane në Shqipëri **bej**. Krijimin e mjedisit shqiptar përkthyesi e vazhdon më tej me pijen tradicionale shqiptare, **rakinë**, në vend të **vodkës**, aq të pranishme në çdo tavolinë e festë ruse. Prirja e përkthyesit për t'i perceptuar e për t'i përcjellë elementet e kulturës së huaj nga këndvështrimi i kulturës së vet, e ka shtrembëruar informacionin kulturor, e ka vënë lexuesin përpara një teksti joautentik.

Ja edhe një zgjidhje tjetër e gabur e po këtij përkthyesi në dramën e A. Çehovit "Kopshti i Vishnjave". Për fjalinë **Ты всё об этом** (Ty vsjo ob etom), e cila nuk përmban asnjë element kulturor specifik, përkthyesi ka parapëlqyer njësinë frazeologjike me ngjyrim të theksuar kombëtar **Ti gjithnjë këngën e Mukës**, e cila në rrafshin semantik është barasvlerëse, por në rrafshin kulturologjik e gabuar. Fare mirë përkthyesi mund të kishte përdorur një shprehje neutrale ose edhe një frazeologjiem, por pa emra të përveçëm shqiptarë të tipit **Muke**, p.sh., **Po të njëjtat gjëra na the ose I bie fyellit në një vrimë**. Shprehje të tilla me ngjyresa të theksuara kombëtare, si **Kënga e Mukës**, **E ëma e Zeqos**, **Opingat e Sheros**, si **Xhaferi simiten etj.**, që ne i kemi në majë të gjuhës, nuk mund t'i injektohen kulturës së tekstit origjinal. Në një

Përmasa kulturore në përkthim dhe "mëkatet" e përkthyesit

Nga prof.dr. Avni Xhelili



përkthim të tillë do të kishim dominim të kulturës pritëse ndaj kulturës së huaj. Po kaq e dukshme në të do të ishte edhe dora e përkthyesit, ndërkohë që autori i veprës do të mbetej mbetej në hije.

Përkthyes të tjerë realiet kulturore jo vetëm që nuk i mënjanojnë, por përkundrazi, në përkthimet e tyre bëhen përpjekje për të shpalosur me besnikëri të gjitha veçantitë e origjinalit. Po sjellim disa ilustrime nga dy përkthimet e romanit rus "Mjeshtri dhe Margarita", i shkruar gjatë viteve 1929-1939 nga Mihail Bullgakovi (1891-1940). Është një roman satiric fantastik i mbushur plot me realie historike e kulturore ruse e sovjetike, por edhe me realie të kulturave të lashta greko-latine e hebraike, të cilat për lexuesin tonë janë të panjohura ose pak të njohura. Dy përkthimet e kësaj vepre janë të dhjetëvjeçarëve të fundit: i pari i përket vitit 1994 nga Lili Bare (për shkak të cilësisë shumë të keqe të shtypit, ilustrimet janë nxjerrë nga ribotimi i Prishtinës, i vitit 2005), ndërsa përkthimi i dytë është i vitit 2020 nga Aleksandër Koli.

Po analizojmë kulturonimet **Пилатчина** (Pilatchina) dhe **богомоз** (bogomaz), të përdorura në tekstin e mëposhtëm:

... (статья), где автор ее предполагал ударить, и крепко ударить, по Пилатчине и тому богомазу, который вздумал проташить (опять это проклятое слово!) ее в печать.182

1. ... (artikull), ku autori propozonte që të demaskohej pa mëshirë dhe ai **zhgarravitës ikonash**, të cilit i qe shkrepur të përjetësonte **pilatizmin** në faqet e një libri të botuar (përsëri kjo fjalë e nemur). 149

2. ... (artikull), ku autori rekomandonte të goditej, dhe të goditej fort mbi **Pilatizmin** dhe këtë **zograf ikonash**, të cilit i qenesh shkrepur ta fuste atë në shtyp kontrabandë (përsëri kjo fjalë e mallkuar). 214

Me kulturonimin e gjuhës bisedore nga fusha e fesë **богомоз** (bogomaz) në rusisht kuptohet një ikonograf i keq, i paaftë. Është përdorur nga autori me kuptim përçmues. Konotacioni i saj negativ është kuptuar dhe përcjellë saktë në përkthimin e parë (**zhgarravitës ikonash**), ku përkthyesi ka kalkuar jo fjalën, por kuptimin tekstual të elementit kulturor. Në përkthimin e dytë kemi kalkim të pjesëve përbërëse të fjalës, por elementi i huaj **zograf** jo gjithnjë ka kuptim negativ, ashtu siç e kërkon konteksti.

Sa i përket kulturonimit **Пилатчина** (pilatchina - term i sajuar nga autori që lidhet me Ponc Pilatin nga provinca romake e Judesë), të dy përkthyesit e kanë dhënë si **Pilatizëm**, ku prapashtesa me burim të huaj **-zëm**, që nënkupton gjendje ose sistem doktrinash, nuk mbart atë kuptim negativ e fyes, të cilin ia jep fjalës ruse prapashtesa **-чин**. Nga ana tjetër, përkthyesi i parë, duke transformuar strukturën e fjalisë, ka modifikuar kuptimin e saj. Nga teksti i përkthimit kuptohet sikur objekti i demaskimit është autori (zhgarravitësi i ikonave) dhe jo fenomeni i **Pilatizmit**. Edhe togjet e fjalëve në kllapa (**përsëri kjo fjalë e nemur!**) në original janë vendosur në dy raste pas së njëjtës folje проташить (protashçit' - tërheq zvarrë). Këtë element të rëndësishëm përkthyesi në njërin rast e shmangur, ndërsa në rastin tjetër e ka vendosur pas një fjale tjetër pa efektin e duhur. Më afër origjinalit është zgjidhja e përkthyesit të dytë, i cili togjet në kllapa i ka vendosur pas fjalës **kontrabandë**, çka i përfaqëson kuptimit kontekstual të foljes ruse **protashçit'**. (Fjala është për kontrabandimin në roman të **pilatizmit** si ideologji fetare, i cili, po të botohej, përbente rrezik për shoqërinë sovjetike antifetare). Mendoj se një shënim i përkthyesve për elementin gjuhësor **pilatchina** do të ishte më se i nevojshëm.

Kulturonimi tjetër i gjuhës ruse **пить запоем** (pit' zapojem) [...дядю Фёдора, пившего... запоем] (110) nga L. Bare është përshkruar si **tërë kohën s'bënte gjë tjetër... veçse pinte e dehej** (92), ndërsa A. Koli e ka përcjellë si **pinte e bëhej xurxull** (134). Varianti i parë është më afër origjinalit, ndërsa varianti i dytë është më larg perceptimit të fjalës ruse **zapoj** si gjendje dehjeje nga pirja e alkoolit pa ndërpreje për ditë të tëra, mesatarisht nga tri deri në dhjetë ditë, ndërsa për ata që kanë një lloj stazhi në konsumimin e pijeve alkoolike, ajo zgjat edhe një muaj. Meqenëse kjo dukuri sociale e shoqërisë ruse nuk ka përkime analoge në kulturën shqiptare, mjet i vetëm për ta përcjellë atë në përkthim mbetet përshkrimi ose përkufizimi i saj. Varianti i L. Bares mund ta redaktohej në këtë mënyrë: (**xha Fjodori**) **rrinte i dehur për ditë të tëra pa ndërpreje**.

Le të shqyrtojmë edhe disa zgjidhje përkthimore për toponimet dhe antroponimet të përdorura nga Bullgakovi në roman, ngjarjet e të cilit zhvillohen në Moskën sovjetike të viteve '30 të shekullit XX dhe në Jershalaimin (Jeruzalem) e dy mijë vjetëve përpara.

Dihet se toponimet përbëjnë hapësirën kronotoponimike të veprës, vendin dhe kohën e zhvillimit të ngjarjeve. Ashtu si realiet e tjera, ato pasqyrojnë historinë dhe kulturën e vendit, ruajnë informacione për veprimtarinë e njerëzve në epokë të ndryshme, për ngjarje e personalitete historike, për



1

Mbi gjithë sa është shkruar për poezinë Me Zogajt më tërhoqi një deklarami i tij, si të gjeja në të çelsin magjik, jo atë kopil. Përherë ka një çels, disa i thonë kod, sikurse e ka dhe muzika çelsin sol. “Në poezinë time ka më shumë muza se gra që kam dashuruar dhe se jo rallë poezive të bukura të dashurisë u mungon adresimi konkret”.

Muzat qënkëshin në poezitë e bukura të dashurisë dhe ku mbetet të jenë gratë? Pse fshihet “adresimi konkret” sikurse fshihen në server prova dekonspirimi? Mos vallë frymëzimi tejkalon pasionin? Mos duhet të ketë në art më shumë abstragim se lëndë jetësore? Mos kemi të bëjmë me raportet e avullit me ujin? Avulli krijoi epokë duke lëvizur trenat, avulloret, por dhe uji turbinat. Nëse e lexon poezinë e Zogajt të shkruar ndër vite, qoftë matanë kufirit të '90-ës apo këndeje, edhe pse kanë ndodhur përmbysje shoqërore, zor se ua gjen moshën. Kronikat humbasin orientimin kohor, duke mos kuptuar se cilat janë shkruar në diktaturë dhe cilat në demokraci. (Se mos Naimi shkroi në liri.) Në poezi është po ajo nënë, po ajo e dashur, po ajo natyrë, po ai hall, veçse ndryshojnë emocionet, gjendja shpirtërore, perceptimet, me të cilat është e mbushur jeta e autorit, që, nëse e lexon, pasuron dhe jetën tënde. Për të kuptuar arqipelagun e librave të Preç Zogajt kushtuar dashurisë, jetë pas jete, moshë pas moshe do na ndihmonin vargjet e Rabindranath Tagorës tek poezia “Dashuri e pavdekshme”: “Zemra ime e magjepsur ka thurur e rithurur gjerdanin e këngëve./...Jetë pas jete, moshë pas moshe, përgjithmonë”.

Duhet thënë se poetët e viteve '80-të nuk ishin të angazhuar kundrejt temave të mëdha, sikurse ishte kusht për brezat paraardhës të krijesëve. Poezinë e orientuan nga natyra e virgjër dhe jo nga ajo e transformuar e socializmit. Preferonin t'i këndonin burimit dhe jo kanalit vaditës. “Diç dua të them e nuk mund ta them./ Mëkat të flasësh kur fjalën e saktë nuk e gjen” Tundet në shilarsin e dilemës, ngaqë nuk do të mëkatojë me fjalën, nëse e zhvesh nga fuqia shprehëse, ngjyrimet, mikropërçuesit e ndjesive të holla. “Fjalët vdesin në një poezi/që kam zor ta shkruaj.” Arti është vuajtje për atë që e krijojnë dhe kënaqësi për atë që e lexon, sikurse ndodh me kalimin e energjisë mekanike në atë elektrike. Edhe pse i drejtohet vajzës që do, e cila i ka thënë harromë, ai e pret si zakonisht në vetmi, sepse dhe jeta e tij e tillë ka qenë: i mësuar të presë atë që ia largojnë me përdhunë. Është mëkat, që në poezi të

Rreth poezise së Preç Zogajt

Më shumë muza se gra të dashuruara

Nga Fatbardh Amursi (Rustemi)

ketë fjalë të pasakta, sepse ndjenjat janë si reaksioni zinxhir i çeljes së sythave apo gonxheve, ku s'ndodh të dalë një gjethe e vyshkur apo një lule plastike. Boton libër me 101 poezi dashurie, në kontrast me një realitet, ku urretja përngjan me erërat që vijën sa nga Saharaja, apo i ftohti polar. As vetë s' e di pse më shkoi mendja tek dënimi me 101 vite, ndoshta prej vargjeve: “Gjithë këto plagë i hapi dashuria./askujt s'i del jeta t'i shërojë.” Në Iliadë e vetmja perëndi që plagoset është Afrodita. Me plagët që mbart nga dashuria poeti ia kalon dhe Gjergj Elez Alisë.

Deklarimi i autorit se në poezinë e tij ka më shumë muza se sa gra të adresuara, duke vënë frymëzimin para erotizmit, ku e vetmja skenë e nxehtë shprehet në vargjet “kur kujtoj se kam qenë mjaft i krishterë/përpara se t'lexoja të plotë Ungjillin./ Kur kujtoj puthjen që më dhe në Korçë.”, ndërsa diku tjetër “format e fytyrës së saj lakohen në erë/ndjekur prej duarsh të uritura/që s'do t'i arrijnë kurrë”, të krijojnë idenë e një platonizmi të rremë. Vajza ka fytyrë dhe i mungon trupi. Një fytyrë që endet në eter, e paarritshme, e cila lë pas duar të uritura, duke më kujtuar Mollën e Tantalit, që largohej sa herë që një dorë zgjatej ta arrinte. “Mirë e dija se trupin e kisha pengesë./njëlloj si regjimin në kazerme/...po mos të të prekja me duar të tjera/që morën vite të bëheshin të mijat.” Vargje të çuditshme këto për të kuptuar ngërçet e heroit lirikë, ku ndalesat e shoqërisë duket sikur i shfaq si të vetat. Kulti i së bukurës nuk njih partner tjetër veç atë që e percepton si hyjneshë. Që ta meritojë duhet që “mos të tw prekja me duar të tjera, që morën vite të bëheshin të mijat.” Edhe Romeo zor se e plotëson këtë kusht për të qenë i denjë për Zhuljetën. (Që kur Hënën e shkeli këmba e njeriut, ajo e humbi magjinë për poetët.)

Në të përditëshmen mbushur me kronika rozë femra ka humbur magjinë, erosi me kollajllëk përfundon në skena porno dhe heroit lirik po duket si ata djemtë,




që e shpenzonin kohën poshtë ballkonit të vajzës, ku prekjet u lireshin ëndrrave. “Në vijë të drejtë ne qemë/...plot frikë për t'u afruar.” Dhe në fund të mbyllur në një dru, sikur të jenë zogj që bëjnë folenë në trungun e pemës. Ç' të jetë kjo frikë për t'u afruar: mosbesim, hezitim, apo refleks i një kohe me narkomanë, të prekur nga sida, racizëm, trafikantë të “mishit të bardhë”? Të kujton frikën e kopshtarit mos lulet nuk po zënë kokrra. Për më tepër kur ndodhet para një bajameje që ka çelur heret. “S'do të fle më kurrë, s'do ta nxjerr nga kujtimi/fytyrën e vajzës që më mbështolli/me një shikim të ëmbël e mw bwri burr...”. A gjen sot një të ri, që të jetojë i mbështjell me shikimin e ëmbël të një vajze?! Me sa duket heroit lirik ka harruar se në ç' shekull jeton, kur tek e sotmja: shtrati i nxehtë tërheq më shumë nga shtrati i topit. (Kur u shpjegojta nxënësve “Vuajtjet e djaloshtit Verder”, duke u thënë se në kohën e Gëtes, kishte të rinjë që fill pas leximit të librit nga trishtimi mbyteshin në lumë, ata qeshnin.) Edhe tek poezia “Pjekuria” ka vuajtje. “Të ulesh sytë përdhe, të mbledhësh grushtat./ të mbash me forcë në fre përbrënda kafkës/një zgjim të ri zymbylash./përgjunjen në

altarin e vashës./Të vuash një kob në grykë, të hedhësh armët./Të shpallësh pa betejë kapitullimin.” I pëlqen të ndihet i mundur para vajzës, ngaqë dafinat ia lë asaj. Sa torturose është: “të mbash me forcë në fre...një zgjim të ri zymbylsh.”?! Nuk të shfaqet në përfytyrim një tjetër grua, veç ajo e Zojës së Papërljeme, sepse ndjesitë për femrën marrin përmasa hyjnore. E idealizon, sikurse dhe Naimi, që pranonte të bëhej pluhur e baltë, që ta shkelte këmba e saj. Apo Çajupi: “Deshe dritë, o qiell./More dritën time”. Në rrafshin moral ndihet një kthim në motin e shkuar, ku femra mund të udhëtonte e vetme dhe të mos prekej nga askush. Stonon apo ofron një model të harruar, atë të romantikut me prerjen e re të imazhinistit? “Çasti i rrezikshëm/si top rrokulliset/rrugëve të fatit.” Më se e vërtetë, më se realiste, për të gjithë ata, sikurse personazhi i Dostojevskit tek “Netët e bardha”, që të jetuarit e një çasti i jap vlerë gjithë jetës së tij. Por, ndodh të shfaqet dhe një ndjesi më e butë ndaj fatit: “E nanurisim./E përkëdhelim...”, jo për ta vënë në gjumë, se muzat nuk flenë.

2

Pa një vëmendje të shtuar ia djeg shanset vetes, për të shijuar vargje, që përherë ruajnë një befasi. Sikurse toka ka fuqi tërheqëse, po ashtu dhe arti. Nuk mund të shkruhet për bukurinë, për dashurinë, moshë pas moshe e jetë pas jete, pa një artikullim të fjalës, pa një lëmim të vargut, pa stilin që skalit individualitetin. “Më dhe dikur shpirt e shpirt të dhashë./dhe qysh atëherë s'po ngrysej ajo ditë./padita dhe padite, the dhe thashë./fitova sytë e tu, humba të mitë.” Nëse në tregtinë me klering malli këmbëhet me mall, në dashurinë pa llogarira meskine shpirti këmbëhet vetëm me shpirt, nuk po shkëmbehet robrit e luftës, por, në fund, i fituar del vetëm njëri: “fitova sytë e tu, humba të mitë”. Të shikosh me sytë e tjetrit veten, ndoshta një shans, që s' duhet refuzuar. (“Ai ka njëqind sytë e Argusit për të zbuluar njollat e të vëllait, a mund të jetë kaq i verbër për vetveten?” - shprehet një nga personazhët e Shilerit në dramën “Hajdutët”). Të tillë janë kritizerët dhe delirantët.) “Koha ndalon në dritaren time./herë si plagë në prerje vetime./...pa e marrë vesh lajmin e saj në xham./trembur njëllor prej frikës dhe gëzimit.” Edhe në kohën e orakujve që e vështirë të kapje sinjalet e kohës, të merrje vesh lajmet e saj. Dritarja është ekrani i parë i njerëzimit. Edhe imazhi i vajzës prej andej i shfaqet. Po pse “trembur njëllor prej frikës dhe gëzimit”? Nuk ka gjë tjetër që të jetë më i rrezikuar nga gëzimi. Sa e sa lëndohen, kur



u buzëqesh fati, kur arrijnë një sukses, se i shohin me një qind sytë e Argusit, për të gjetur njollat. (Mbretëreshës Geraldinë i qe rrënjësuri deri në fatalitet, se po të pëlqente një gjë, nuk do të bëhej kurrë e saja.) “Ne na njohu një e tretë, Dashuria /Ajo qëndronte mes heshtjes sonë/kur shiheshim gjatë si dy të pagojë/dhe e dinim para tjetrit çfarë ka në mendje tjetri./dhe flisnim dyshe edhe kur flisnim me vete./...ku pasi bënim dashuri më dorëzoje/më të çmuarin e gjërave, gjumin tënd.” (Perëndesha Hera, kur i duhej të bënte ndonjë aventurë, e vinte Zeusin në gjumë.) Nga poezia “E treta është dashuria” krijohet një paradoks, se vetëm në dashuri i treti është i tepërt?! Këtu Zogaj shfaqet si lasgushian: “Nuk dashuronim as unë as ti, po dashuronte dashuria.” Si mundet që kënaqësia t’i jepet një pale të tretë? Mos kjo e treta, është preferenciale, sikurse hyjneshat e Olimp, që nuk u shfaqeshin cilitdo, veç atyre, që kishin për zemër?! E vetmja përgjigje: hyjnizimi i ndjenjës, që bën kontrast me realitetin banal. “Të lirë në largësi,/plot frikë për t’u afruar,/se nuk ishim vetë ne, por ishin shëmbëllimi/i krijesave më të dëlira që ndjenja ka krijuar”. Ndjenja duke krijuar shëmbëllesë, kurmi del në plan të dytë. Gjithë këto portrete grash, vajzash, nuk janë pak dhe, duke iu munguar trupit, lënë imazhin e muzave prej nga poeti merr frymëzimin. Ndoshta më mirë nga unë, për ta ilustruar alternimin e muzës me të dashurën, do e thoshte Meri Mezini në poezinë “Muza ime”: “Kush s’ka muzë brenda vetes/shpirtin zbratur ka gjithnjë.” Muza ka fytyrën e Afroditës apo të Deas së Butrintit.

Poeti ka shkruar për nënën e tij, moshë pas moshe dhe jetë pas jete, ndërsa për babanë nuk më ka rastisur të lexoj. (Përgjigjen e mora duke lexuar novelën “Bija e vjetër e nënës së re.”) “Tani që dimri erdhi nga të katër anët./Ti, nënë, mbështillesh me duart e tua./Në fund të oborrit shikon me habi/si bien gjethet, si zhvishen drurët.../Dhe loja e zogjve në çerdhe duket.../ Po unë kam ikur,/Motrat janë martuar,/Me radhë na hoqi koha/Nga shtrati yt, nënë.” (Koha do heq edhe më shumë në demokraci, duke shkretuar dhe vendbanim e nënës së tij). Ndërsa nëna rri me sytë nga rruga, në qiell: “Vija e bardhë e avionit duket!” Në një atdhe të izoluar, a provokon kjo “vijë e bardhë avioni”? Rruga e qiellit ku endet pegasi, kjo vijë e bardhë ngjall shpresë. Por, dhe shpresa nuk e ditka rrugën e saj: “Ku më çon, ku më mbyll/o shpresë, o mall i zi?/Ti më fsheh prej njerëzisë midis njerëzisë.” Njihet humori i zi, ja që paska dhe mall të zi? Ndaj Zogaj kërkon prej poetëve që të mallëngjehen, përkundër nostalgjisë. Të duket, sikur ky rënkim del nga shpirti i një nënë, por jo: është poeti, në çastet e vetmisë dermuese, kur ka muzën, por i mungon e dashura. Prapë i mangët është, kur ka të dashurën dhe i mungon muza. I duhen të dyja, sikurse rrinë bashkë: mendimi dhe ndjenjat. “Rrugët e Tiranës janë plot me studentë/ Ky rrotullim i hijshëm fustanesh, gjethesh/ më kujton... më përmend./Më dënon vetmia ime!/Derdhet helmi i gozhdëve të ngulura/mbi fjalët e ndrydhura, hovet e ndaluara.” Sikurse Migjeni flet për “vullnete të ndrydhura”, edhe Zogaj pa rënë ende diktatura përmend “fjalët e ndrydhura”.)Mos vallë të rritur me privimet dhe mungesat e kohës, ku lejohej epika dhe erotit i vihej gërshëra, poeti vuan shkrehjen e dëshirave? (Ndryshon bota, por jo rregullat për të shkruar në parajsë. “Ky rrotullim i hijshëm fustanesh, e gjethesh”, një vallëzim hutues, më kujton një poezi të Hygoit kushtuar Atlasit, i cili mbante mbi shpinë botën, ndërsa në një

lëndinë lodronin vajzat me fuqinë ndjellëse të sirenavë, por ai i kishte duar e zëna.

Poezia e dashurisë është oazi i tij, kur të tjerët krijojnë rezervate. “Për pak arrita qiellin./qiellin e poetit,/kur isha djalë i ri me flatra në gji./...Për pak arrita qiellin, por, ah lotët e saj!/Për pak e arrij qiellin, por ah ky tren i vjetër/Më ngujon me orë nën portale që pikojnë...”. Pengesat veçse i shtohen për të arritur “çastin e lum”, sepse: “Kam probleme me shpirtin:/Pambarim e tashmja zëvendëson të ardhmen./... Një trëndafil që vyshket/m’i bën me faj mendimet.../Po unë do ta arrij, do ta arrij qiellin/Makar atë çast kur të shtyp hijen time.” E shkruar në dhjetor 1989. Kuptohet, të shtypë hijen, të vrasë frikën, t’u shpëtojë erinive, perëndisë së hakmarrjes. (Pablo Nerudën e përdoqi prej vitesh një rrobë ushtarake.) Nga nevoja për t’u zbratur ai lëshon vargun: “Por sa të gjatë e paske krahu, o mallkim!”

Befas, del një zë, si prej honit: “Ç’fjalë të ëmbla për bukën thatë!/Për rrenat pompoze, ç’heshtje e gjatë!...Çasti i rrezikshëm/mbetet prapa.../E shkuara dridhet/Si fushë e minuar.” Poezia është shkruar në shtator të vitit 1988. A nuk ju duket kurajose përmendja e “bukës së thatë”, e “rrenave pompoze”, apo e shkuara që dridhet si fushë e minuar? “E kërcet m’u thanë/Se dua të rroj sot e pastaj./Dhe rroj pa faj!” Një deklaram ky në përputhje me nderin e panjollësor kalorsiak. Nuk mund të shkruash për gjithë jetën poezi dashurie, nëse ke qenë një aplikant i urrejtjen klasore. Xixëllonjat kanë një veti të admirueshme, largohen nga mjediset e ndotura. Dhe një poeti lirik nuk mund t’i ofrohen muzat, nëse në shpirtin e tij rëndojnë gjynahe. Dashuria fal mëkatën, por jo fajin. Edhe kur falen gjaqet, kjo bëhen në emër të jetës, por jo të dashurisë.

“Ke ardhur t’me marrësh me vete? Dhe unë s’ të pyes se ku./E di se mirë është me ty/gjithkund, gjithandej, gjithherë/por di ndërkohë se s’do mund/ta lë këtë vend të mjerë./Si klithëm nga pas do më vijë/në fund të dheut po shkova/fantazmë me mua do të rrijë/natë e ditë po durova./Jo, jo mos m’i hidh ata sy/ku viset vrapojnë si pulëbardha./E rëndë është ardhja me ty/dhe shumë e rëndë mosardhja.” Edhe këtu ai bën dallimin, duke mos iu përgjigjur një dashuria që e largon nga viset e tija. Sa e sa nuk do e refuzonin këtë shans. Jo se do të bëjë atdhetarin, por se poeti nuk e duron dot mungesën e atdheut, sepse më shumë se kushdo ka detyrime ndaj tij. Edhe ata që janë larguar, mos i llogarisni si të ikur. Ata jetojnë edhe më shumë me fatet e vendit të tyre. Nëse avionët të largojnë nga atdheun, është pegasi, kalë fluturues që të kthen, pa nevojën e Kostandinit. “Poezinë më të bukur ende s’e kam shkruar”, është shprehur poeti. Që do të thotë se muza e tij nuk ka shterrur. As mos prisni që ai të thotë një ditë: “E shkrova poezinë më të bukur!” Nëse nuk e ke shkruar poezinë më të bukur, zor se e fiton ofiqin poet. Fundja, nuk është ai që e përcakton, se cila prej poezive të shkruara është më e bukura. Por ky deklaram, në fakt, nuk duhet marrë si objektiv i paarritur. Kur poeti, thotë se poezinë më të bukur nuk e kam shkruar, duhet kuptuar se ai në çdo libër që boton e rrit stekën. Se sukcesi nuk i bëhet shtrat për të fjetur. Dafinat kanë vlerë për të, kur muza i vë në ballin e së dashurës. “Bukuria jote/i shpëton mendjes/së kapur nga çikërrimat.”

Të jesh me vite në shoqërinë e muzave, do e arrish qiellin. Të rritesh me idealin e së bukurës, doemos ke krijuar imunitet ndaj së rëndomtës. Nuk është e lehtë të shkruash për dashurinë me virtytin e kohëve të shkuara, duke u përballur me veset e të sotmes.

ROMANI “PROVINCA” I LIRIDON MULAJT MERR ÇMIMIN “REXHAI SURROI” PËR LETËRSI



“Ky roman të bën të mendosh se edhe ti e ke një histori të ngjashme, por pse nuk e ke shkruar deri më tani, apo nëse do të mund ta shkruash ndonjëherë... Ndërsa provinca nuk është kurrë diçka e re, veçanërisht qytezat industriale pa asnjë lloj identiteti të periudhës postkomuniste. Vula që ajo lë te gjithsecili prej nesh është gjithmonë diçka origjinale, çka zëbërthet me mprehtësi dhe nga një pikëvështrim krejt i veçantë në këtë roman, përmes një autoportreti psikanalitik, ku preken me guxim edhe indet më të fshehta të natyrës njerëzore.

Provinca si dramë, kurth, fatalitet apo alibi e mëvonshme, vjen përmes një rrëfimi të ashpër, të vërtetë, pa asnjë lloj konservanti dhe si i tillë, bindës”.

Luljeta Lleshanaku

“Një marrëdhënie Edipi e përmbysur, ku ka një vërtetësi të frikshme përshkrimi të realitetit. Thyerja e tabuve dhe rrëfimi i seksit të çojnë në erotizëm, por njëkohësisht të ngjallin krupën. Trishtimi, dekadencia, neveria e një zhvillimi të degjeneruar janë sëmundje ngjitëse në këtë provincë. Libër i rëndësishëm, një rikthim në ekzistencializëm”.

Enkel Demi (Tom Kuka)

“Provinca vjen si një rrëfim i mëvetshëm, me peshën e vragave që bart njeriu, çdonjëri prej nesh, pavarësisht copës së qiellit mbi krye. Sepse tregon pa drojë gjurmët që na bëjnë të dallueshëm – veçmas në brenga e bashkë në përpjekjen për të marrë frymë me gjithë kraharorin.

Qoshku i botës ku kemi lindur na ka angështuar secilin. Liridon Mulaj guxon t’i kthehet harresës si kujtesa që na bën çfarë jemi...”

Suela Mino

Publikimi i vëllimi poetik "Marta" mbetet sa festë e bukur personale për autorin Dhimitër Pojanaku, aq sa edhe për lexuesin që e do, çmon, kërkon dhe ble poezinë e autorit, fitues i shumë çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në poezi. "Asnjëherë s'duhet kurrë harruar, që kritika letrare është subjektive. Kritika është një gjykim, një gjykim i vlerës së librave. Po në letra si në jetë, mund të thuhet se janë dy mënyra gjykimesh: Gjykimi i shkurt e i prerë, i pampshetur në arsye; edhe gjykimi i gatitur me dëftime e me shpikje, e i sjellë si një rrjedhë e prituri, jo si i hedhur, si një urdhër mizori. Kur del një njeri dhe më thotë se aksh libër është "fort i bukur", mund të ketë të drejtë, por nuk jam i shtërnguar t'i zë besë fjalës së tija. Edhe një çau shpreh një dragat mund të presë me hanxhar gjykime të atilla. Kritika është një punë tjetër, dhe ca më e vështirë. Kur pëlqen dhe kur ç pëlqen një vepër, nuk arrin të këcej a të çfryj: duhet të shfaq përsetë e pëlqimit atë çpëlqimit tim, në qoftë se dua të përpigem të shokësor këndonjësit në një ndjenjë me mua, shkruan Faik Konica në "Kohëtore e letrave shqipe". Kësaj, në qasjen ndaj këtij vëllimi poetik do ndalojmë me lexuesit në tri figura, që përbëjnë stacione poetike, në krijimtarinë e Dhimitër Pojanakut. Ato janë Deti, Nëna dhe Marta. Ndërkaq, duke qëndruar te e para, kujtojmë se vargu i tij konçiz e lakonik ndërherësh, mbart një det të madh mendimesh sa Adriatiku e Joni bashkë, e duket sikur e lënë në hije liqenin dhe meditimin për të, që mbase poeti e anashkalon qëllimshëm. Çuditërisht poeti madhështon detin në varg, pikërisht atë, figurën e tij më të gjendur në poezinë që ai shkruan, ide e rrënjësuar kjo tek unë edhe prej intervistave që Pojanaku ka dhënë herë pas here ndër media. Sikundër thinjet deti; sa më tepër më ikin vitet, aq më tepër të ngjaj det; shoh pulëbardhat që fluturojnë ikin nga deti në mal, zog fluturojnë në qiell apo rrjedh si lumë drejt detit; etj., janë pika orientimesh që ndriçojnë farin e tij krijues. Sepse Deti është i gjerë dhe i thellë në shpirt!

Sepse Deti:
Mban dy botë!
Njërin
Poshtë,
Lindur nga barku i vet,
Tjetrën,
Lart,
Mbi lëkurë,
Që nuk e njeh!
Edhe kur ndodh, që botët përmbysen,
Ja sjell fati,
Jo shpirti!
Sepse:
Kur ndahen toka dhe deti
Ka fajtor?!
Deti që tërhiqet
Apo toka që nuk lëviz as gishtin ta joshë,
Të jetë një vendim i të dyve për të
provuar fuqinë e dashurisë?

Sepse:
Zemra më lundron me ditë e më net' në
det të hapur
e s'pyet për moshën
Sepse:
Lumenjtë bëhen pleqpo s'u derdhën në det,
e malet sheshohen po nuk mbajtën qiell.

Në këtë lundrim poetik Deti mbetet kryfigura më e përfaqësuar e Pojanakut, për t'u pasuar nga ajo e NËNËS së poetit, që edhe pse ka ndërruar jetë, troket në poezinë ambiguë, e cila të grish për lexim. Mungesa është forma më e lartë pranisë së dikujt që ka ndërruar jetë, ndaj në vargun e Pojanakut, figura e nënës dhe vdekjes, personifikohen si një e gjitha. Në perandorinë e kalçiumit poetik krijohet një gjendje e etertë.

Në je nisur për tek unë,
Hiqe rroben e zizë.
Boll e llastuat mortjen!
Të panë tek mbaje dhimbjen time
përkrahu, nënë!

I ratë rrotull shtëpisë

Si nuk kam qenë asnjëherë te varret
natën?!

"MARTA" E POJANAKUT, POETIT KONÇIZ E LAKONIK!

Nga Dr. Ilir Shyta

Si nuk ma shtiu askush ndërmend?!
Nën pipëtimë,
T'i përgjoj të mitë,
Në flenë apo rrotullojnë dherin.

Perandoria e bardhë/ Eshtë shtrirë mbi
botë

Pa kufij,
Se të gjithë flasin gjuhën e gjumit.

...varrezat

Me pikëllimin,
Ushqejnë lulëzimin.

MARTA është figura më e re, ndalesë në stacionin tonë, por që sigurisht nënkuptohet edhe si ekzistencë e mëhershme në figurën vajzërore, që mbart krijimtarinë e Pojanakut. Nëse ti e pyet poetin, a mos Marta ngjason me një X portret femëror, Dhimitri nuk të lë ta përfundosh mendimin. Gjithmonë sipas tij, Marta mbetet sharm poetik, që lartëson emrin e njeriut në letrat shqipe. Të paktë janë librat që mbajnë për titull

katëgorinë e emrave të përveçëm, ndonjëherë edhe në bashkëpunim me folje, lidhëza e përcaktorë. Në këtë poezi, poeti sinjalizon se e ka parë Martën shtatë herë, por ajo nuk e pa asnjëherë, sepse sytë e saj visheshin me avuj gëzimi. Të gjithë ikin në jetë, vetëm emri është shenjuesi që mbetet dhe tregon pavdekësi. Poeti e pa Martën teksa hiqte nga mollëzat rozë të gishtrinjëve borë, ca grimca prej dheut të lagësht. E pa edhe tek mbyllte ditën lehtësisht, si perdet e një dritareje. E pa të arratisur ikonash kishtarë, te çezma e vareve apo dyqani i çantave... Pra, shkrija e kohës e bën poezinë e Pojanakut të marrë formën e monologut autobiografik dhe t'i japë atij gjithmonë tisin e koherencës. Duke shkriur kohët në një të vetme, fitohet leximi vertikal, që përpos atij horizontalit, përcjellin mesazhe të gjithëpëlqyera për lexuesin.

Shtatë herë e pashë Martën sot.
Te pagëzimi i Naumildit,
Si flakë e dalë nga ikonat,



Ish stolisur me fustan të kuq në të verdhë.
Te i riu Gjokë,
Shtrirë ku ish kazani i pagëzimit,
I ranë mbi pelerinën e hirtë në të zezë,
Ca pika lot rruazë
Sa dhe prifti u nemit.

Te krijimtaria e Pojanakut në përgjithësi, por dhe në veçanti të "Marta", theksojmë se sendërtohet raporti fabul/gjendje, raport ky i plotësuar edhe përmes një figuracioni origjinal, ku mbizotëron më së shumti ajo e metaforës. Në këtë sens, poezia e tij, fiton emocionin e ngjarjes dhe përcjell meditimin te lexuesi. Dhe në këtë bashkëlexim autor-libër-lexues, duket sikur para teje shfaqen një film ose video artistike, me protagonistë gjithsecilin nga ne, për të provuar ekzistencën e rrotjes sonë mbi këtë dhe.

Titujt e poezive në krijimtarinë e Dhimitër Pojanakut mbeten art më vete. "Fjalët e fundit të një vjeshte tërmet", "Flur", "Zbehje në fytyrën e miqësisë", "Lulja e greminës", "Duart e anonimatis", "Çarqevënësit", "Puthja tragjike e muajti shkurt", "Monologu i verdhë", "Monologu i një dite çudi", dhe "Qeni i emigrantit", janë titujt më intrigues të këtij vëllimi, që padyshim së bashku me titujt e tjerë, përbëjnë vlerë të gjithësisht në republikën e letrave shqiptare. Titujt, herë të shprehur me simbole, herë me metafora e herë me paralelizma figurativë, fare bukur të emocionojnë dhe të shtyjnë drejt idesë së një poezie të mirë, pa nisur leximin e saj. Titujt vijjnë të shkriur më mënyrë organike e të njehsuar me përmbajtjen e mesazheve, përmes një damari të dukshëm dhe të spikatur që mban në unitet formën me përmbajtjen. Në këtë sens logjike, të largëtat vijjnë pranë e të afërtat bëhen ëndërr poetike, sepse poezia e Dhimitër Pojanakut është një sistem i modifikuar dhe shpesh tekanoz, brenda së cilës njehsohen poetika e përjetësisë me stilin lirik.

Në "Teorinë e Letërsisë" kemi dy lexime të një vepre letrare. Lexim të brendshëm dhe lexim të jashtëm. Leximi i brendshëm është analiza kontekstualiste e këtij vëllimi poetik që po kryejmë në këtë moment dhe analiza e jashtme përfshin dukjen e librit, thënë shkurt dhe saktë, kopertinën, por dhe botimin në tërësi të librit. Mesa duket gjendjen fluide të Martës, piktori pogradecar Henri Shkruti e ka realizuar plot fantazi e suspansë, që lexuesi ta mendojë vetëm të bukur Martën e Pojanakut. Ndërkaq, koceptimi i një botimi luks, i kuruar deri në detaje nga shtëpia botuese "Onufri" është realizuar me finesë.

Ardian - Christian Kycyku
për Dhimitër Pojanakun

Të rrallë janë poetët e shqipes, të cilët e shohin botën me një shqetësim kaq të rafinuar, me një ndjeshmëri që shpeshherë kap paroksizmin dhe që kanë me vdekjen një afëri kaq të natyrshme.

Nga kjo afëri ngjizen imazhe poetike drithërues dhe me një fuqi të rrallë. Bjemë ndesh me një harmoni të epërme, ku ngjyra, tingulli dhe kuptimi i fjalës rrjedhin njëherësh dhe mbeten të paharrueshme.

Perifrazim nga parathënia e librit
"Shtëpia ime rrotullon qiellin", botuar në
gjuhën rumune, Bukuresht, 2000.

Dhimitër Pojanaku

MARTA



OnufriPoezi

Boshllëqet e pashmangshme të njohurive njerëzore kanë qenë gjithmonë të mbushura me besime irracionale të cilat e kanë shpënë artistin drejt miteve. Kozmogonia është bashkimi i miteve dhe teorive, që çdo popull ka zhvilluar për të shpjeguar origjinën e universit, duke shtruar pyetje si: nga cila kohë-hapësirë vijmë? Prej cilës materie përbëhemi? A ekzistojnë vërtet koha dhe hapësira përreth nesh, apo ato janë thjesht një iluzion perceptues-mendor i qenies njerëzore? Kozmologjia, nga ana tjetër është tërësia e doktrinave shkencore ose filozofike që studiojnë rendin, dukuritë dhe ligjet e universit. Në këtë lëm të mendimit lindi dhe "E KUQJA", si temë e edicionit të XVI-të të Ekspozitës Kombëtare "Salloni i Vjeshtës", ku artistët u ftuan të interpretojnë të kuqen si ngjyrë, si koncept, si hapësirë, si përkatësi, si ndjenj, si qasje filozofike, e jo vetëm, pasi e kuqja është e vetmja ngjyrë që mbart antonime të skajshme si; dashuria dhe urrejtja, pasioni dhe ashpërsia, e bukura dhe e shëmtuara, parajsja dhe ferri, drita dhe errësira etj... Ekspozita është e konceptuar në aspektin kuratorial si një libër i realizmit magjik, i cili shfletohet vepër pas vepre dhe që mbart brenda vetes copëza të ndryshme të shpirtit krijues të secilit artist pjesëmarrës.

Kur flas për të kuqen i referohem kozmogonisë, që është pashmangshmërisht e lidhur me kuptimin e "mitit të krijimit", duke shpjeguar kështoj krijimin nëpërmjet ligjeve të natyrës, si pjesë e një procesi të përbërës. Ndërsa kozmologjia mitike e shpjegojnë atë në mënyrë narrative si rezultat i procesit zhvillimor nën mbrojtjen e një Nume (fuqisë hyjnore). Në këtë pikëpamje rendi mitologjik, ndryshe nga ai shkencor që është i domosdoshëm për vazhdimësinë e jetës *in perpetuum*, është diçka që ka ndodhur më vonë, me krijimin e qenies njerëzore. Ndaj jetëgjatësia e rendit mitologjik është e lidhur ngushtësisht me atë të jetëgjatësisë së ekzistencës së qenies njerëzore, e ndarë nga procesi krijues i universit kohë-hapësirës, ashtu si dhe ai i artistit me krijesat e tij mbi kanavacë. Për shumicën e kozmogonive, kozmosi zanafillor është i përbërë nga dy parime të kundërta, por plotësuese mes tyre dhe të identifikueshme me një ngjyrë të vetme, që është e kuqja.

"E KUQJA" u materializua falë artistëve më në zë të artit pamor shqiptar si: Gazmemd Leka me veprën e tij "*Jus primae noctis*", ku nëpërmjet një gruaje lakuriq përcjell simbolikën e intimitetit të "natës së parë"; Shpresa Beqiri dhe Nikolet Vasia shfaqen me dy tablo përsëri lakuriq, ku në njërin shtriqet natyrshëm muza e tij e përbotshme dhe në tjetrën, të Shpresa Beqirit ndodh procesi hyjnor i joshjes seksuale; Alfred Mirashi Milot na shpjen në një tjetër përmasë konceptuale me punën e tij, me "*Red key*"; - "çelësi i njerëzimit", ai që depërton psikikën përmes të kuqes; Agron Hoti, që nëpër zgavrat e abstraktes kërkon të shpëtoj pikërisht atë; "*Mbijetesën e të kuqes*". Në të vërtetë abstraktja shfaqet edhe në veprat e Abaz Hados dhe Admir Përvathit, ku i pari shndërrohet nëpërmjet imazhit në një libër surreal fluturues dhe i dyti kllapit të kuqen mbi kanavacë.

EDICIONI I XVI-TË I EKSPOZITËS KOMBËTARE
"SALLONI I VJESHTËS"

E KUQJA,
KOZMOGONIA E
KOHË-HAPËSIRËS

Nga Dr. Oltsen Gripshi, Kurator i ekspozitës



"*In front of the animals*" është vepra e Ols Plasës, i cili nën petkun e simbolikës së kafshëve na zbulon veset dhe virtytet e qenies njerëzore, apo Meri File, që për herë të parë prezantohet për publikun me një skulpturë të quajtur "*The Soul*", një pikëtakim midis qenies dhe natyrës, veçanarisht një thëllëze, e cila ngre folezën e saj mbi shpinën e një mashkulli.

Ironia e tranzicionit të shoqërisë shqiptare gjen vend në veprën "*Bella ciao*" të Fatmir Jukës, si kundër

brishtësia femërore gjen intimitetin e saj falë freskisë së bojrave të ujit mbi letër në veprën "*Evaporazione*" të Erjon Nazera. Për t'u theksuar në këtë edicion të XVI-të të Ekspozitës Kombëtare "Salloni i Vjeshtës" është ndërthurja e stileve, teknikave, qasjeve estetike dhe brezave të artistëve pjesëmarrës, sepse brenda saj përpos bashkëkohores gjen edhe kompozime figurale të artistëve si: Gavril Priftuli me mitologjinë "*Murimi i Rozafës*", Anastas Kostandini, i cili na zhvendos pas në kohë me "*Skenë lufte*

ilire" dhe "*Kali i shqiponjës*", Bujar Zajmi, ku natyra shndërrohet dhe kodifikohet përmes gjuhës së përthyerjeve gjeometrike me "*Çifti nudo*".

E kundërta ndodh me "*Zodiakët ilirë*", veshur me të kuqe të Moikom Zeqos të cilët mbartin me vete misterin e poezive të tij, apo "*Puthja e përflakur*", një portret dualist, që evidenton psikologjinë e një gruaje nën pushtetin e një burri. Paharruar vibrimin e tejdukshmërisë së qelqeve të natyrës së qetë të Greta Tahiragës, e cila formësohet si një *Tableau Vivant* falë instalacionit ndërveprues midis natyrës së qetë reale mbi tryezë dhe asaj të pikturuar heshtur mbi kanavacë.

Artiol Izri në krahasim me artistët e tjerë na vendos në një përmasë krejt të ndryshme të kohë-hapësirës, pasi vepra e tij "*Tinguj*" rrëfen historinë e vërtetë të një vajze 6-vjeçare të quajtur Emily, por të shndërruar në një personazh, ku gjithkush gjen veten. - Pema e jetës po vuan... gjithësinë e pret errësira. Në këto momente paqendrueshmërie ekzistenciale vetëm pastërtia e shpirt të një vajze bionde e me sy jeshil mund ta sherojë plagën e rëndë që ka kapluar njerëzimin. Është përballja mes dy botëve dritës dhe errësirës, të mirës dhe të keqes në dyluftim mes tyre. Diku larg në zbrazëtinë e gjithësisë oshtinë një rrahje reaktori... Shpresa e fundit për të shpëtuar njerëzimin...

...një copë metali? A ka shpirt një android? E nëqoftëse ka, a është i denjë? Çfarë forme merr shpirti i tij? Kjo është dilema e këtij rrëfimi, ku personazhi arrin t'i mbijetojë dhe ta mposhtë zbrazëtinë e errësirës me forcën e tingujve të pianos së saj.

Në të vërtetë janë tinguj e të kuqes së kësaj ekspozite, ku NE zgjedhim jo thjesht t'i mbijetojmë ngjeshjes së kohës nën efektin e morfinës, që turbullon mendjen nga dehja e opiumit qumështor të lulëkuqes, por për t'i dhënë kuptim kohës - duke jetuar.



Më kujtohet (unë nuk kam të drejtë ta nxjerr ngoje këtë folje të shenjtë, vetëm një njeri në faqe të dheut e pati këtë të drejtë dhe ky njeri ka vdekur) me një lule të errët pasionareje në dorë, tek e vështronte, ashtu siç nuk e ka vështruar kush, edhe sikur ta ketë zhbiruar me sy për një jetë të tërë, që nga mugulli i agimit gjer në mugullin e natës. Më kujtohet fytyra e heshtur me tipare indiane dhe krejt e largët prapa cigares. Më kujtohen (besoj) duart e tij të mprehta prej endësi. Më kujtohet pranë këtyre duarve, një mate me stemën e Uruguajit; më kujtohet në dritare një thurimë e verdhë, me një pamje të vagullt liqeni. Më kujtohet qartazi zëri i tij; zëri i avashtë, i hidhur dhe hundor i banorëve të lashtë të periferisë, pa vërshtëllimat italiane të sotme. Nuk e pashë më shumë se tri herë; herën e fundit, më 1887...

Më duket fort i lëvdueshëm plani që të gjithë ata që kanë patur lidhje, të shkruajnë për të. Ndoshta dëshmia ime ka për të qenë më e shkurtra dhe pa dyshim më e varfra, por jo më pak e paanshmja e librit që keni për të botuar. Mjerisht, të qenit argjentinas nuk më lejon të thur ditrambe – gjini e detyrueshme në Uruguaj kur bëhet fjalë për ndonjë uruguajan. *Shkrimtaruq, spitullaq, kryeqytetas*; Funes-i nuk i nxori nga goja këto palavira, por për të, e kam mendjen top, unë i përfaqësoja të gjitha ato hatara. Pedro Leandro Ipuche-ja ka shkruar se Funes-i ishte një pararendës i mbinjerëzve, “një Zarathustra në gjendje të egër dhe autokton”; nuk e kundërshtoj, por nuk duhet harruar se edhe ai ishte një nga ata mendjemëdhënjtë e lokalitetit Fray Bentos, me ca kufizime të pashërueshme.

Kujtimin e parë për Funes-in e kam përpara syve. E shoh një muzg marsi a shkurti të vitit tetëdhjetë e katër. Atë vit im atë më kishte shpënë të veroja në Fray Bentos. Së bashku me kushëririn tim Bernardo Huedo-n po ktheheshim nga ferma e San Francisco-s. Ktheheshim kaluar me këngë në gojë dhe nuk qe vetëm kjo arsyeja e lumturisë sime. Pas një dite me ufëm, një shtrëngatë e madhe ngjyrë plloçash kishte zënë qiellin. Era e Jugut e shponte me hosten, kishin zënë të shkallonin pemët; pata frikë (shpresë) se mos na zinte në fushë të hapur uji fillestar. Bëmë një lloj gare me shtrëngatën. Hymë në një rrugicë që thellohej mes dy trotuareve shumë të lartë me tulla. Ishte errur përnjëherë; dëgjova çape të shpejtë dhe pothuaj të fshehtë sipër meje; ngrita sytë dhe pashë një djalë që bridhte nëpër trotuarin e ngushtë dhe të thyer njëlloj si mbi një mur të ngushtë dhe të thyer. Më kujtohen pantallonat e tij të gufmuara, opingat; më kujtohet cigarja në një fytyrë të ashpër, drejtuar për nga një re e madhe që atij çasti ishte bërë e pafund. Papritur, Bernardo-ja i thirri: *Sa është ora Irene? Pa i hedhur sytë nga qielli, pa ndalur çapin, tjetri iu përgjigj: Për katër minuta shkon tetë, rioshi Bernardo Juan Francisco. Zëri i tij qe i mprehtë dhe tallës.*

Unë jam aq hutaq sa dialogu që rrëfeva më sipër nuk do të më kishte tërhequr vëmendjen, sikur im kushëri, i shtyrë besoj nga një soj krenarie lokale dhe nga dëshira për t’u rrëfyer mospërfillës ndaj përgjigjes tripjesëshe të tjetrit, të mos kish këmbëngulur.

Ai më tha se djaloshi që takuam udhës ishte një i quajtur Irene Funes, i famshëm për çuditë e tij. Nuk përzihej me askënd dhe e maste kohën tamam si orë. Im kushëri shtoi se e ëma e tij punonte si hekurosë në fshat dhe quhej Maria Clementina Funes; kishte zëra që thoshin se i ati i Irene-ut, një anglez me emrin O’Connor, punonte si mjek në fabrikën e kriposjes, ndërsa, të tjerë thoshin që ai ishte, ja zbutës kafshësh, ja këshilltar i departamentit të Salto-s. Irene-u banonte me t’ëmën dy hapa larg pronës së Laureles-it.

Më tetëdhjetë e pesën dhe tetëdhjetë e gjashtën e kaluam verën në Montevideo. Më tetëdhjetë e shtatën u ktheva në Fray Bentos.

J.L. BORGES

FUNESI = NJERIU I KUJTESËS

Përktheu nga origjinali Mira Meksi

Natyrisht pyeta për të gjithë të njohurit aty dhe më në fund për “Funes kronometrikun”. Më thanë se e kishte gremisur një kalë gjysmë i egër në fermën e San Francisco-s dhe se kishte mbetur ulok për gjithë jetën. Më kujtohet se lajmi që dëgjova qe si një magji bezdisëse: të vetmen herë që e pashë, ne vinim kaluar që nga San Francisco-ja, ndërsa ai ecte përgjatë një pingu të lartë; ajo që rrëfente im kushëri kishte diçka prej ëndrrë të ngjizur me elemente të dikurshme. Më thanë se qëndronte i mbërthyer në shtat, me sytë të ngulitur mbi fikun e sfondit, apo mbi një rrjetë merimange. Muzgut lejonte që ta nxirrnin te dritarja. E cyste krenarinë gjer në atë pikë, sa të

gjasmonte se i dukej e këndshme rrufeja që e kishte goditur... Dy herë e pashë përmes rrjetës që tallurazi e theksonte më shumë robërinë e tij të përtjetshme: një herë, rrinte pa lëvizur në shtat, symbyllur; herën tjetër sërish qëndronte pa lëvizur, i përpirë krejt në soditjen e një degëze santonine erëmirë.

Asokohe, jo pa një soj tangërlleku, i kisha hyrë studimit metodik të latinishtes. Në valixhen time gjeje *De viris illustribus-in* e Lhomond-it, *Thesaurus-in* e Quicherat-it, komentet e Jul Cezarit dhe një volum të paplotë të Plinit, që i tejkalonte (dhe vazhdon t’i tejkalojë) njohuritë e mia modeste prej latinisti. Nuk ka gjë që s’merret vesh në një fshat të vogël; Irene-ut, në rançin

e tij të largët nuk vonoi t’i shkonte në vesh mbërritja e atyre librave të çuditshëm. Më drejtoi një letër ceremoniale, të qëndisur bukur, në të cilën kujtonte takimin tonë, fatkeqësisht tepër të shkurtër të “shtatë shkurtit të vitit tetëdhjetë e katër”, ngrinte në qiell shërbimet e lavdishme që don Gregorio Haedo-ja, xhaxhai im, i cili kishte mbyllur sytë atë vit, “u pat bërë të dy atdheve ditën e guximshme të Ituzaingo-s”, dhe më kërkonte t’i huaja njërin prej librave që kisha me vete, të shoqëruar me një fjalor “për t’iu futur tekstit origjinal, pasi ende nuk e njoh latinishten”. Premtonte të m’i kthente në gjendje të mirë dhe pothuaj përnjëherë. Gërmat ishin të përsosura, shumë të stërholluara; ortografia ishte e tipit që sugjeronte Andres Bello-ja: *i* në vend të *y* dhe *j* në vend të *g*. Në fillim, natyrisht, kujtova se bënte shaka. Kushërinjtë më siguruan se ajo nuk ishte shaka, qe një nga ato marrëzitë e Irene-ut. Nuk dija në duhet ta quaja pacipëri, padije apo budallallëk, kokëkrisjen e tij për ta përballuar latinishten e ndërkryer vetëm me një copë fjalori; për t’i dhënë një dush të ftohtë, i dërgova *Gradus ad Parnassum* si edhe veprën e Plinit.

Më 14 shkurt një telegram nga Buenos Aires-i më thoshte të kthehesha menjëherë sepse im atë “nuk ishte aspak mirë”. Më ndjeftë Zoti; ndoshta prestigji që më jepte ardhja pikërisht mua e atij telegrami urgjent, dëshira për t’i rrëfyer Fray Bentos gjithë kontradiktën që ekzistonte midis formës mohore të kumtit dhe ndajfoljes “mirë”, tundimi për ta dramaturgizuar dhembjen time duke gjasmuar një stoicizëm burror, nuk më lanë pikë mundësie për të ndërë dhembje. Tek bëja gati valixhen vura re se më mungonte *Gradus-i* dhe vëllimi i parë i *Naturalis historia*. “Saturni” e ngrinte spirancën të nesërmen në mëngjes; atë mbrëmje, pas darke shkova në shtëpinë e Irene-ut. U çudita që nata ishte po aq e rëndë sa dita.

E ëma e Irene-ut më priti në rançin e mirëmbajtur.

Më tha se Irene-u gjendej në dhomën e skajshme dhe se nuk duhet të çuditesha po ta gjeja në errësirë, pasi e kish bërë zakon t’i kalonte orët e vdekura qirifukur. Kapërceva pation e shtruar me plloça dhe rruginën; mbërrita në pation e dytë. Kishte një pjergull; errësira m’u duk pus. Befas, dëgjova zërin e lartë dhe tallës të Irene-ut. Ky zë fliste në latinisht; ky zë (që vinte nga errtia) gërmëzonte me një ëndje të zvergur një fjalim, një lutje a një nomatisje. Rrokjet romane tingëlluan në pation e shtruar; frika m’i bënte të padeshifrueshme, të pafundme; më pas, në dialogun e madh të asaj nate, mora vesh se përbënin paragrafin e parë të kapitullit të njëzet e katërt, të librit të shtatë, të *Naturalis historia*. Lënda e këtij kapitulli është kujtesa; fjalët e fundit qenë *ut nihil non iisdem verbis redderetur auditum*.

Pa më të voglin ndryshim në zë, Irene-u më tha të hyja brenda. Ndoshtë në shtat duke tymosur. Kam përshtypjen se nuk ia pashë fytyrën gjersa agoi; mbaj mend thëngjillin e çastshëm të cigares. Dhoma mbante një aromë të vagullt lagështire. U ula; përsërita historinë e telegramit dhe të sëmundjes së tim eti.

Kam mbërritur tani në pikën më të vështirë të rrëfimit tim. Ky (është e udhës që lexuesi ta dijë) ka të bëjë vetëm me dialogun që u zhvillua përpara gjysmë shekulli. Nuk do të rrekem të riprodhoj fjalët e tij, tashma të pagjendshme. Parapëlqej të përmbledh me besnikëri gjithçka që më tha Ireneu asaj nate. Ligjëratat e zhdrejtë është e largët dhe e dobët; e di që po sakrifikoj forcën e rrëfimit tim; le t’i përfytyroj lexuesit e mi kohëndërprerjet që më dërmuan asaj nate.

Irene-u e nisi duke numëruar në latinisht dhe spanjisht, rastet e kujtesës së jashtëzakonshme të dhëna nga *Naturalis historia*: Kiri, mbreti i persëve, që thërriste në emër secilin nga ushtarët e ushtrive



“Artisti është krijues i gjërave të bukura,” shkroi Oscar Wilde. Por, tabloja *Guernika*, (1937) e piktorit spanjoll Pablo Picasso (1881-1973), nuk është e bukur, ajo është mizore dhe barbare. Ajo është një tablo e vdekjes dhe errësirës së buruar prej lakmisë njerëzore. Dhe a janë vdekja dhe errësira të bukura? Në fakt, vdekja është mungesa e jetës dhe errësira mungesa e dritës, por kjo vepër e vdekjes vlon me jetë dhe kjo pikturë e errët është plot dritë. Një paradoks midis dy botëve. Një betejë midis dy emocioneve të territ e dritës, në të cilën shikuesi dëgjon thirrjen që del prej saj se jeta është fitimtare, njeriu duhet ta dojë atë, dhe se i gjithë njerëzimi duhet të ecë në dritë e jo të vetëasgjësohet në luftë.

Arti si bukuri është veçse një iluzion, vetëm një refleks i fytyrave dhe attributeve të shumta të artit. Kjo vepër është një dokumentar, vajtim i një kombi, manifest politik e njerëzor, simbol i kubizmit dhe shkëlqimit të mendjes dhe penelit të Pablo Picasso.

Ajo nuk është e bukur. Ajo është një kryevepër e dhimbjes.

I madhi Oscar Wilde, ishte shkrimtar romantik, dhe artin e lidhte ngushtë me bukurinë, por ai u nda nga jeta në fund të vitit 1900, pak javë përpara fillimit të shekullit më gjakatar të njerëzimit, në të cilën shpërthyen dy luftra botërore, dhe në të cilin vdiqën tri herë më shumë njerëz sesa të gjithë viktimat e luftës të marra së bashku në historinë e njerëzimit. Kësisoj, për artistët e shekullit të njëzetë, arti nuk mund të ishte thjesht bukuri, por një pasqyrë dhimbje, vdekje, terrori, e mbi të gjitha një deklaratë e manifest i shkruar nga dora e njerëzimit.

Teksa shkelja me ngadalë mbi pllakat e hirta në muzeun *Reina Sofia* në Madrid, me t'u përballur me këtë tablo u drithërova i tëri. Të gjithë vizitorët e mbanin frymën përpara kësaj vepre, si një homazh për jetët e shuara dhe qytetin bask të shkatërruar që frymëzuan artistin, por edhe si një reagim instinktiv përballë vdekjes.

Tabloja nuk ka ngjyra. E gjitha është e pikturuar me vaj në kanavasë me ngjyrë të zezë, gri, dhe të bardhë, me dhjetra tonalitete të hijes, e me përmasa 3.6 metra e lartë dhe 7.8 metra e gjerë. Ajo është e mbushur me figura dhe simbolika të shumta. Por, kjo tablo e jashtëzakonshme është ndërtuar mbi një histori të dhimbshme.

Guernika është një qytet i vogël, në krahinën e Biscay në teritorin bask të Spanjës. Gjatë Luftës Civile Spanjolle 1936-1939, ajo konsiderohej si bastioni verior i lëvizjes republikane të rezistencës dhe epiqendra e kulturës bask, por kjo nuk ia shtonte rëndësinë atij qyteti si objektiv për sulm shkatërrimtar. Guernika ishte vetëm një qytezë e zakonshme, por eksperimenti i shkatërrimit që ishte planifikuar për të e tejkalonte mëshirën dhe integritetin njerëzor.

Gjatë Luftës Civile Spanjolle forcat republikane përbëheshin nga fraksione të ndryshme (komunistë,

GUERNIKA: KRYEVEPRA E DHIMBJES

Dr. Bledar Kurti



socialistë, anarkistë, etj) me qasje të egra e të ndryshme ndaj qeverisë dhe rezultateve që kërkonin, por ata kishin një kundërshti të përbashkët ndaj nacionalistëve. Këta, të udhëhequr nga gjeneral Francisco Franco, ishin gjithashtu të fraksionuar por në një masë më të vogël. Ata kërkonin një kthim në ditët e arta e të lavdishme të Spanjës, shtetin ligjin, rendin dhe vlerat tradicionale të familjes katolike, dhe ishin të vendosur t'i arrinin ato përmes dhunës e luftës.

Rreth orës 16:30, të hënën, më 26 prill 1937, luftëtarët e legjionit gjerman Condor, të komanduar nga koloneli Wolfram von Richthofen, bashkë me forca italiane të Musolinit, bombarduan Guernikën për më shumë se tri orë. Avionë me fluturim të ulët hodhën bomba e qëlluan me mitralozë edhe banorët e fshehur nëpër ara. Gjermania, në atë kohë e udhëhequr nga Adolf Hitler, u kishte dhënë mbështetje materiale nacionalistëve dhe po e përdorin luftën si një mundësi për të testuar armët dhe taktikat e tyre të reja. Operacioni i bombardimit i hapi rrugën gjeneralit Franco të merrte Bilbaon duke siguruar fitoren e tij në Spanjën veriore. Qyteza e Guernikës nuk kishte ndonjë vlerë ushtarake të madhe në vetvete, dhe bombardimi ishte thjesht një ushtrim ushtarak për të testuar përdorimin e

bombave të civilët e pambrojtur. Bota nuk kishte përjetuar kurrë më parë një shfarosje masive të pafajshmish me këto mënyra, me këto përmasa dhe për qëllime të tilla mercenare.

Atë ditë rrugët ishin përplotë me banorë të qytetit dhe fshatarë të ardhur nga rrethinat. Asnjëherë më parë në luftën moderne nuk kishte patur masakër të njerëzve në numër të tillë dhe me mjete të tilla. Ka ende debate mbi numrin e saktë të viktimave, flitet për rreth dy mijë njerëz, por një sulm ushtarak mbi një popullatë civile indinjoji mbarë opinionin publik ndërkombëtar, dhe artistët nisën ta demonstironin indinjatën dhe furinë e tyre përmes pikturave, vepre letrare dhe muzikore.

Në këtë tablo vërehet në mënyrë të menjëhershme se të gjitha figurat shohin në të majtë. Duket se ato i apelojnë shikuesit të shohin majtas, si burimi i vetëm i shpëtimit dhe çlirimit. Picasso shquhej për pikëpamjet e tij politike komuniste, dhe ai mbeti besnik ndaj komunizmit deri në ditën e vdekjes, ndaj kjo thirrje e dukshme për t'u drejtuar nga e majta si zgjedhja më e mirë për një komb duket qartë përmes drejtimit dhe lëvizjes së figurave.

Në këtë vepër gjenden 6 njerëz, 3 kafshë, 1 bimë dhe një dritë. Figura qendrore e tablosë është kali, simbol i

mishërimit të vuajtjeve. Një njeri mund të ushtrojë vullnetin e tij, të lehtësojë dhimbjen e tij; një kafshë është e pafuqishme në mëshirë. Picasso foli për kalin si përfaqësues i popullit, ndaj në trupin e kalit vërehen shumë vija, të reshtuara si gurë varresh, një homazh për viktimat. Secila vijë simbolizon një jetë të shuar. Dhe dallohet në plan të parë një plagë, një e çarë në qendrën e trupit të kafshës, si një goditje vrasëtare për një komb.

Në qendër, piktura e Picasso-s ka në tërësi një kornizë letrare që përmban skica nga “i çmenduri” i Niçes, në disa koncepte të vepre të tij, dhe nga mitet e Perseut, Pegasos dhe Meduzës. Mbi tablo bie një dritë e thyer, gjendet një grua me llambë, dhe ndonëse disa pjesë janë të shpërbëra, vërehet një trup i zbrëthyer në fund. Në kompozim vërehen tragjedi të mëdha njerëzore si një nënë duke i klithur me dhimbje qiellit me fëmijën e pajetë në duar, apo figura në të djathtë kërkon shpëtimin nga rrënojat, por edhe motive të marra nga letërsia, krishtërimi dhe mitologjia, të cilat janë ndërthurur me tragjedinë e Guernikës.

Picasso zgjodhi të përdorte titullin e vepres së Niçes, *Lindja e tragjedisë nga fryma e muzikës*. Ai krijoi një instrument muzikor me krahë. Instrumenti muzikor me krahë është një lahutë. Por Picasso bën një kthesë e trillim nga filozofi egzistenencialist. Forma e hapur trupore është syri i Hitlerit dhe Hitleri është një kukull e së ligës. Prandaj, tragjedia e shpalosur në këtë tablo të jashtëzakonshme nuk lind nga fryma e muzikës, por nga syri i së keqes që dallohet në krye të tablosë. Si një shaman në një shpellë, Picasso transformon imazhet e tij. Picasso ka marrë një titull nga Niçe, e cila ka të bëjë me lindjen e tragjedisë artistike dhe e ka shtrembëruar atë titull për të treguar se si lind një tragjedi njerëzore në jetën reale. Kënetat e vogla në anën e majtë të gjermimit përfaqësojnë vargjet muzikore. Dy krahët e Pegasos shndërrohen në një valë; prandaj, manifestohet Shpirti i Muzikës. Pegaso simbolizon lindjen e jetës dhe Picasso jep mesazhin se edhe nga tragjedia mund të lindë jetë e re.

Në tablo shihet një grua që luan rolin e një burri. Shihet një fener në një dorë të çmendur. Gruaja me krahun e gjatë dhe llambën mund të jetë i çmenduri i Niçes me fanar i përshkruar në këtë pasazh:

A nuk keni dëgjuar për atë të çmendur që ndezi një fener në orët e ndezura të mëngjesit, vrapoi tek tregu, dhe bërtiti vazhdimisht: “Unë kërkoj Zotin! Kërkoj Perëndinë! “... Ku është Perëndia? ... Po ju them që e kemi vrasësit ti dhe unë. Të gjithë ne jemi vrasësit e tij.

Dora e stërgjatur që mban fenerin e drejtuar nga syri në krye të tablosë është arsyeja e cila kërkon të mësojë të vërtetën, kërkon të kuptojë arsyen e lindjes së kësaj tragjedie, dhe për më tepër, t'i tregojë shikuesit se ai syri i ligë në krye është shkaktari i luftës.

Një figurë tjetër që zë një vend

të rëndësishëm në tablo dhe tërheq vëmendjen e shikuesit është demi. Ai duket i tërbuar; me hundën duke shfryrë dhe bishtin duke e rrahur. Tërbimi dhe kafshëria shpalosen dukshëm përmes demit. Lufta me dema është një ndër elementët më të rëndësishëm zakonor e traditor në Spanjë. Dhe kjo kafshë manifestohet në shumë vepra të Picasso-s dhe artistëve të tjerë spanjollë por edhe më gjerë, siç ishte Ernest Hemingway i cili u tërhoq dhe u magjeps nga ajo traditë. Demi si shpirti i Spanjës. Kjo vërehet në këtë tablo e tashmë njihet ndër kombëtarisht.

Shumë popuj të botës e kanë të mitizuar këtë kafshë. Ne e dimë nga historia se demi ishte kult adhurimi si tek hebrenjtë e rebeluar ndaj Jehovës adhtu si kafshë sakrifice në Mesopotami, Romë, e vende të Mesdheut. Në Greqinë e lashtë demi mori një transformin dhe domethënie të re përmes Minotaurit, një përbindësh me trupin e një njeriu dhe kokën dhe bishtin e një demi. Minotauri ishte pasardhësi i mbretëreshës së Kretës Pasifa dhe një demi madhështor. Tek *Guernika* demi ka formën e gërmës H, e cila mund të jetë referim për Adolf Hitler, pra një krijesë përbindësh, një shartim midis bishës së huaj Hitler dhe njeriut vendas Franco. Një përzjerje njeriu dhe kafshë që shfaqet shpeshherë si tematikë në artin surrealit, dhe që manifestohej natyrshëm prej shekujsh në traditën spanjolle të luftës me dema.

Një komb tjetër mund ta shohë si barbarizëm traditën e luftës me dema pasi nuk arrin dot ta perceptojë njësimin e bishës me njeriun, vdekjes me dashurinë, vrasjes me fisnikërinë, arkaizmin me instinktin modern, dhe pasionin kafshëror për jetën. Pasi dola i tronditur nga muzeu *Reina Sofia*, me goditjen emocionale që më kishte dhënë *Guernika*, disa orë më vonë u ula në shkallët e *Plaza del Toros* të Madridit për ta përjetuar vetë këtë koncept të shartimit midis jetës dhe territ, e shpalosur si vdekje fisnike, e për të kuptuar më mirë afekcionin e Picasso, Hemingway, dhe Francisco Goya, me

atë simbol të traditës dhe vetë zemrës spanjolle. Dhe me të nisur ndeshja, unë nisa të kuptoja dhe të cekja brenda vetes përzjerje emocionale të papërjetuara më parë. Matadorët, pikadorët, dhe bandarillerot përballë një bishe që duhej vlarë me fisnikëri. Një demi që, pavarësisht përfundimit të ndeshjes, ishte gjithnjë heroi dhe viktimë, fisniku dhe bisha. Disa turistë anglezë u ngritën dhe u larguan të tronditur duke thirrur me zë të lartë: barbarizëm, ky është barbarizëm, por spanjollët nuk ua vunë veshin pasi ata kishin gjak tjetër në arteriet e tyre mesdhetare. Kur bisha lëshoi frymën e fundit nën goditjen e vetme e fisnike të matadorit, të gjithë spektatorët u ngritën në këmbë duke duartrokatur heroin e gjallë dhe bishën e vdekur, dhe u dëgjuan trumbetat, dhe një karrocë e artë u duk në arenën me rërë, dhe litarë lidhën brirët e demit me karrocën, e ajo nisi ta tërhiqte demin në forma rrethore, si homazh për atë sakrificë që lidh njeriun me të përtejmen. Dhe unë aty kuptova se çfarë kuptimi kishte në të vërtetë ajo kafshë për atë komb, dhe përse Picasso duhet ta pikuronte patjetër në kryeveprën e tij. Ndaj edhe vetë Picasso u shpreh në një intervistë se “demi është brutaliteti dhe errësira.”

Ashtu si figurat e tjera në këtë vepër, demi shikon majtas, por hija e tij është më shekullore, pasi vërehet syri i tretë, ai syri i lashtë egjiptian i ndjesisë së gjashtë që shërben si një urë minotareske midis jetës dhe të nëndheshmes, dhe demi duket se përveç mitit kombëtar dhe hijes hitleriane, prezanton edhe rrugën e ferrit. Te vepra *Komedia Hyjnore*, Dante dhe Virgjilli hynë poshtë dhe në të majtë në zbritjen e tyre në ferr. Ndaj, shoqëruar me stigmatën e vizatuar në dorën e njeriut të shtrirë, luftëtarit me shpatë të thyer porsia një hero e martir pa lavdi, ferri dhe kryqëzimi i Krishtit prezantojnë dualitetin e qenies njerëzore, atë të humbjes dhe sakrificës.

Shenja e stigmatës, njeriu i shtrirë me krahë të hapura në formë kryqi, gjendet te vepra *Dita e Tre Majit, 1808*

e Francisco Goya, ndërsa gruaja që shtrëngon fëmijën e gjendet te *Pasojat e Luftës* e Paul Rubens. Picasso ndërthuri elementë të këtyre dy veprave ikonë të tmerrit të luftës, për të treguar se ja cilat janë pasojat e luftës, pavarësisht shekujve dhe popujve. Lufta vret. Lufta është terror. Lufta është vdekje.

Kjo vepër është një provokim simbolik, një dokumentar tragjik, por edhe një mesazh i fortë indinjate dhe zemërimi personal. Në fillim të luftës civile, Picasso ishte emëruar drejtor i muzeut Prado në Madrid, ndonëse vetë jetonte në Paris. Dhe kur mësoi për bombat e rëna në muzeun e Prado, në shtëpinë e kryeveprave dhe thesarin e artit spanjoll, ai u inatos shumë me luftën dhe me gjeneralin Franco i cili kërkonte ta shkatërronte totalisht muzeun Prado. Ndaj artisti bëri me dhjetra e dhjetra vizatime parapërgatitore për tablonë *Guernika*, të mbushura me mllef dhe indinjatë. Ai e punoi atë në studion e tij në Paris e cila u zu e gjitha nga ajo telajo gjigande, e Picasso duhet të përdorte shkallë për të punuar mbi të. Vepra përfundoi brenda dy muajsh dhe u ekspozua në pavionin spanjoll në Paris ku ndryshe nga ç'mund ta imagjinohet sot mori kritika pa fund dhe nuk u pëlqye aspak nga kritikët e artit. Por pas luftës civile spanjolle, lufta mori përmasa globale, e u kthye në Luftën e Dytë Botërore, dhe tabloja *Guernika* nuk ishte më vetëm simbol i tragjedisë së një populli, por i gjendjes së mjerueshme dhe vdekjes që kishte zaptuar të gjithë botën. Ajo tablo nuk ishte më vetëm një telajo gjigande e stilit kubist, e formave tri dimensionale, e mendimit futurist, por ishte një fakt real, që e gjithë bota po e prekte. Ndaj *Guernika* u bë fytyra e vërtetë e realitetit ku gjendej bota, dhe ajo, bota, nisi ta shihte dhe ta vlerësonte ndryshe.

Bashkë me artistët dhe njerëzit e mëdhenj lindin edhe histori e legjenda të mëdha, në të cilat padyshim protagonistët janë vetë këta njerëz. Picasso ka shumë të tilla, por ndër

më të njohurat është ajo ndodhi, gjatë një dimri të ftohtë të vitit 1941, ku tekta punonte në studion e tij në Paris, Picasso pati një vizitë kontrolli, por edhe admirimi për mjeshtrin, nga disa ushtarë gjermanë të Gestapos, të cilët, tekta vërtiteshin nëpër studio duke pipëtuar punët e tij, vunë re disa kartolina të riprodhuara nga vepra *Guernika*, të shpërndara mbi tavolinë. Një oficer e mori në dorë njëren prej tyre dhe e pyeti mjeshtrin, “Ju e keni bërë këtë? Jo,” u përgjigj Picasso, “nuk e kam bërë unë, e keni bërë ju. Merreni një kartolinë. Merreni si souvenir për masakrën që bëtet.”

Picasso e la në testament që *Guernika* nuk duhej të kthehej në Spanjë për aq kohë sa Franco ishte në pushtet dhe derisa vendi të drejtohej nga një qeverisje demokratike. Ndaj në vitin 1981, tetë vite pas vdekjes së Picasso-s, pas dyzetë vitesh në mërgim, kryevepra u kthye nga banesa e saj në Nju Jork për në Madrid.

Kjo vepër tashmë është bërë simbol i terrorit të luftës, i dhimbjes njerëzore dhe dhunës ndaj jetës. Ajo është kartolinë e çdo lufte anë-e-mbanë botës, madje ajo kapërcen edhe kohërat, duke simbolizuar si humbjen njerëzore në luftrat arkaike ashtu edhe ato moderne. Ajo flet edhe në ditët e sotme, dhe mbetet tabloja më demaskuese apo e padëshiruar nga zotët apo pionerët e luftës.

“Nuk i takon piktorit të përcaktojë simbolet,” u shpreh Picasso kur u pyet për të shpjeguar këtë vepër të famshme. “Publiku që shikon figurën duhet të interpretojë simbolet ashtu siç i kupton ato.” Kur ne e shohim këtë vepër zbulojmë frikërat tona më të fshehta, por edhe arrijmë në një mendje se *Guernika* na tregon se nuk ka asgjë të re nën diell. Se luftrat e kanë shoqëruar njeriun që në zanafillën e tij, dhe se terrori ka përndjekur të gjithë epokat, por *Guernika* do të mbetet gjithmonë një ikonë anti-luftë, anti-terror, për t'i kujtuar çdo njeriu e çdo jetëmarrësi se çfarë fytyra ka vdekja.



ÇMIMET KOMBËTARE TË LETËRSISË

20 21



ROMANI
MË I MIRË

Agron Tufa, Ngjizja e papërlyeme, Botimet Onufri




VËLLIMI MË I MIRË
ME TREGIME

Durim Taçi, Nga një derë tjetër, Botimet Fishta



VËLLIMI MË I MIRË
POETIK

Visar Zhiti, Dorëshkrimet e fshehta të burgut, Botimet Onufri




VEPRA STUDIMORE
LETRARE MË E MIRË

Dhurata Shehri dhe Persida Asllani, Për një histori të krahasuar të letërsisë shqipe, Botimet Albas



PËRKTIMI
MË I MIRË

Saverina Pasho për përkthimin e romanit Njeriu i parë, të Albert Camus, Botimet Fan Noli



LIBRI PËR FËMIJË
MË I MIRË

Anila Kadija, Ninulla e zemrës, Botimet Albas



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS



QENDRA KOMBËTARE
E LIBRIT DHE LEXIMIT